

LEXMARK
LEGAL

KENI NEVOJË PËR KËSHILLA TË EKSPERTËVE PËR
IMIGRACIONIN NË MB? MOS KËRKONI MË TEJ!

EKIPI YNË I AVOKATËVE ME PËRVOJË TË IMIGRACIONIT ËSHTË I
SPECIALIZUAR NË:

- APLIKIMET PËR VIZË
- VENDBANIM TË PËRHERSHËM
- SHTETËSIA
- RASTET E AZILIT
- APELET PËR DËBIM

NE JEMI KËTU PËR T'JU UDHËHEQUR NË ÇDO HAP
TË RRUGËS. SUKSESI JUAJ NË EMIGRACION
ËSHTË MISIONI YNË!

KONTAKTONI LEXMARK LEGAL SOT PËR NJË TË ARDHME MË TË
NDRITSHME NË MB. PARTNERI JUAJ I BESUAR I IMIGRACIONIT!

ANA: 07435119343 Office: 0208 090 2488
ALDO: 07494181220
SANTJOLA: 07742877853

The Winning Box, Aquis House,
27-37 Station Road, Hayes, UB3
4DX



The Albanian

VITI I 20 I BOTIMIT 25 JANAR 2024

Tel: 020 7018 7929 30 Avenons Road London E13 8HT

SHPOPULLIMI MASIV, DRAMA MË E MADHE E SHQIPTARËVE NË SHEKULLIN XXI



PETRIT KUÇANA
**A MUND TË JETË
DIASPORA
INVESTITORE
STRATEGJIKE NË
SHQIPËRI?**



ARBEN MANAJ
**IKONA E
GAZETARISE
BRITANIKE
PËR TURIZMIN
SHQIPTAR**

**ADN-JA E
SHQIPTARIT**

DAUT DAUTI




**MBAMENDJE ËSHTË
E SHKRUARA!**

KIM MEHMETI



**VIP-I I JETËS
TËNDE**

SONILA MEÇO




**MAGJEPSJE
DHE FRIKË**

GJERGJ META



**VITI I ÇKA
NËSE?**

VETON SURROI



Akoma nuk keni një website?

Akoma nuk jeni regjistruar në Google

Për çdo konsultim mund te vini në çdo kohë në zyrat tona

Adresa e zyrave: 30 Avenons Road, London, E13 8HT
Tel: 020 7018 7929 Mob: 073 4066 5946 Mob: 078 5997 7545




The Albanian newspaper in London


THE ALBANIAN
www.thealbanian.co.uk
www.thealbanian.co.uk

albania7@gmail.com

Tel: 020 7018 7929

**PETRIT KUÇANA**

Ka patur vëmendje të shtuar një lajm i medias shqiptare; Një aktor humor (i afërt në oborrin qeveritar) është shpallur aksioner strategjik për të ndërtuar në bregdetin shqiptar.

Në kushte normale ky lajm nuk do të kishte ndonjë peshë specifike, sikur të mos ekzistonin me dhjetëra denoncime apo qoftë edhe kronika televizive, përveç raporteve

A MUND TË JETË DIASPORA INVESTITORE STRATEGJIKE NË SHQIPËRI?

ndërkombëtare, për vështirësitë e investimeve në Shqipëri. Vetëm në Mbretërinë e Bashkuar janë me dhjetëra denoncime me zë dhe me figurë të shqiptarëve të këtushëm, që nuk ja kanë dalë dot të investojnë në Shqipëri.

Mjafton një kërkim i thjeshtë në internet dhe janë të shumta denoncimet apo qoftë edhe kronikat televizive, sidomos të emigrantëve shqiptarë që kanë investuar në shumë raste kursimet e jetës së tyre, por që mjerisht nuk kanë arritur që të kenë sukses, duke humbur edhe investimet e tyre.

Sipas kronikave nuk është thjeshtë bujqësia apo blegtoaria fusha e investimeve, por edhe industria apo sektorët e tjerë të ekonomisë. A mund të ketë aset më të mirë se sa

diaspora për tu përfshirë në të ashtuquajturat investime strategjike?

Mbase duhet theksuar se pas shkrires së të ashtuquajturës Ministri e Diasporës, thuajse nuk ka patur asnjë zë apo “çështje” që kanë të bëjnë me diasporën, madje edhe ato që u quajten ngrehina institucionale të diasporës sot e kësaj dite nuk dihet nëse ekzistojnë ose jo, apo se cili institucion ka marrë përsipër birësimin e tyre.

Mbase mund të ishte krejt pa kuptim pyetja se a do të duhej diaspora të përfshihej në strategji shtetërore të mirëmenduara qoftë edhe si investitorë strategjik. Ndoshta edhe më racionalët, (të zhveshurit nga emocionet), sidomos ato që e kanë pësuar në kurrizin e tyre, do të argumentonin domosdoshmërinë e të qenurit në oborrin e pushtetit për të

patur sukses. Askush nuk mund ta vinte në diskutim potencialin e jashtëzakonshëm që ka diaspora për të investuar. Vetëm në Britaninë e Madhe besohet se janë mbi 3000 biznese shqiptare, shumë prej të cilëve do të ishin padyshim investitorë potencial.

Deri më sot nuk kemi parë që institucionet e shtetit Shqiptar të vënë ujin në zjarr, për të shfrytëzuar këtë potencial të jashtëzakonshëm. Nga ana tjetër lajmet për braktisjen e

Shqipërisë janë kthyer në një normalitet shurdhues, ku edhe vetë kryeministri përfshihet drejtëpërdrejtë në propagandën e shfrenuar se këtu nuk ka asgjë të keqe.

Mbase dikujt do i bjerë në mend se përfshirja e diasporës do të ishte tejet pozitive për ekonomine e vendit dhe se nuk do të ishte aspak e domosdoshme për të qenë në oborrin e pushtetit. Të paktën sa Kosova... ribotim



AVOKATET E EMIGRACIONIT PËR SHQIPTARET NË UK


Haris Ali Solicitors

If you are a child born in the UK with no immigration status, after 7 years in the UK you can apply straightaway for indefinite leave to remain (ILR).

Call: 0208 8570 7300 | Mobile: 07967 467414 | www.harisalisolicitors.co.uk

19 Kingsley Road, Hounslow, London. TW3 1PA

IMPERIUM CHAMBERS

(ZYRE LIGJORE ME BARISTER TE KUALIFIKUAR PREJ 25-VITESH)

A JENI KONFUZ NGA
NDRYSHIMET E SHUMTA
LIGJORE TE EMIGRACIONIT DHE
KENI NEVOJE PER NDIHME DHE
QARTESI?!

-NUK JENI
VETEMI!

Tel 1: 07901181592

Tel 2: 02072423488

Address: Thanet House, 231-232
Strand, Temple, London,
WC2R 1DA

NE JEMI TE SPECIALIZUAR NE CDO FUSHE TE EMIGRACIONIT

DHE OFROJME NDIHME ME GJITHCKA PERFSHIRE:

Refuzimin e azilit pa te drejte gjyqi
Aplikime/ri-aplikime nga e para
Apelime ne te gjitha gjykatat
Bashkime familjare ose visite ne uk



TELEFONONI **ADELEN** NE **07901181592** PER T'U KONSULTUAR



Keni nje Bizness qe po rritet?

**DONI TE MERNI PUNETOR NGA SHQIPERIA NE
ANGLI?**

TE SPECIALIZUAR NE

BUSSINESS IMMIGRATION
OFROJME APLIKIM TE SIGURTE PER
SPONSORSHIP LICENSE

Bizneset perfshijne:


Kompani ndertimi
Restorante/café
Car washes

Care homes
Office work
Berber

***DHE SHUME BIZNESE TE TJERA**

SHERBIMET QE OFROJME:

- Human Rights
- Judicial Review
- Appeals
- Fresh Claims
- Asylum
- Overstayers
- Stateless
- Detention and Bail
- EEA Family Permit
- ILR/Natyratisation
- Change of Nationality from Kosovan to Albanian
- Work and Student Visa
- Spouse Visa
- Visitor Visa
- Divorce



Email:
adela.bushi@imperiumchambers.co.uk
enquiries@imperiumchambers.co.uk
Website:
www.imperiumchambers.co.uk
YouTube:
The Immigration Barrister



ARBEN MANAJ

Gazeta pro-qeveritare dhe ndër më të angazhuarat në çështjet e emigracionit, "Daily Telegraph", është pikërisht ajo që njofton se Ministria e Brendshme dhe e Emigracionit u ka dhënë mundësinë azilkërkuesve të ardhur përmes La Manshit me gomone, që të punojnë në sektorin e kujdesit për të moshuarit, ndërtim apo në bujqësi.

Emigrantëve të La Manshit ose përndryshe Kanalit anglez, kjo e drejtë u është dhënë në mënyrë të heshtur, ndërkohë që ata kanë vazhduar të kenë akses në hotelet e ofruara për akomodimin e tyre në bazë

të skemës zyrtare të strehimit.

Rreth 16 mijë azilkërkuesve u është dhënë kjo e drejtë e punës nga të ardhurit në 2022, kur shifra ishte më e lartë prej rreth 45 mijë vetëve dhe kur shqiptarët anatemoreshin se kishin pushtuar Britaninë.

Këta azilkërkues kanë marrë faktikisht të drejtën e punës në sektorët e njohur me mungesat më të mëdha në ekonominë britanike dhe paguheshin deri në 80 për qind të normës së pagesës zyrtare, ndërkohë që nëse fitonin më shumë se 49 sterlinat që merrnin në javë si ndihmë sociale ata hiqnin dorë prej kësaj shumë të dhënë nga shteti.

Ky fakt bie ndesh me perceptimin publik se azilantët e La Manshit mbaheshin nëpër hotele dhe nuk u lejohej të punonin, ndërkohë që babai i Brex-it, Nigel Farage që po



sfidon konservatorët në pushtet për zgjedhjet e ardhshme dhe pritet t'u marrë shumë deputetë me partinë e

tij të re, Partia e Reformës, thotë se kjo skemë mund të veprojë si një "faktor nxitës" për të inkurajuar em-

ME GOMONE NË ANGLI/ AZILANTËVE TË LA MANSIT U ËSHTË LEJUAR E DREJTA E PUNËS

igrantët të vijnë ilegalisht në Britani.

Kjo është katastrofë, thotë Farage, dhe nëse trafikantët reklamojnë vende pune dhe strehim, më shumë do të duan të vijnë në Britani, ndërkohë që plani i Ruandës bëhet totalisht irrelevant në krahasim me këtë skemë".

Rishi Sunak këtë javë pritet të ndeshet në Dhomën e Lordëve për planin e tij të Ruandës pasi kërkon fillimin e fluturimeve të riadhesimit këtë pranverë, pikërisht në vitin e zgjedhjeve, por sondazhet e fundit të opinionit publik tregojnë se 50 për qind e të anketuarve nuk kanë besim se plani i Ruandës, i paraqitur nga qeveria do të frenojë ardhjen e emigrantëve të rinj me gomone përmes La Manshit. Madje kjo, sipas tyre, do t'i bëjë të votojnë më shumë për opozitën në zgjedhjet e reja të këtij viti.

HA
HARIS ALI SOLICITORS

KONSULTIMET FALAS

OFFICE: 020 8570 7300 / MOBILE: 07967 467414

We are **Immigration Experts** who have a high success rate in representing thousands of **Albanian** clients with a variety of immigration issues. We have a highly experienced team of immigration solicitors and barristers.

- Asylum / Trafficking
- Overstayers / Human Rights
- Detention & Bail
- Appeals & Judicial Review
- Fresh Claims / Further Submissions
- Indefinite Leave To Remain / Nationality
- EEA Permits / Stateless / Deprivation
- Spouse Visas / Children's Visas

Email: contact@harisalisolicitors.co.uk

19 Kingsley Road, Hounslow, London, TW3 1PA | www.harisalisolicitors.co.uk

LEXMARK LEGAL

EKSPERTËT TUAJ TË BESUAR NË LIGJIN E
EMIGRACIONIT

A PO KËRKONI NDIHMË PROFESIONALE PËR ÇËSHTJET E EMIGRACIONIT?

Mos kërkoni më tej! Lexmark Legal është ekipi juaj i kërkuar i avokatëve ekspertë të imigracionit në Londër, të përkushtuar për të ofruar zgjidhje ligjore të nivelit të lartë të përshtatura për nevojat tuaja.



PSE TË ZGJIDHNI LEXMARK LEGAL?

- Profesionistë me përvojë të imigracionit
- Zgjidhje ligjore të personalizuara
- Ekspertizë e shumëanshme
- Përkushtuar për suksesin tuaj
- Qasje e dhembshur dhe e kujdesshme

Gati për të ndërmarrë hapin e parë drejt zgjidhjes së shqetësimeve tuaja ligjore? Kontaktoni avokatët e imigracionit ligjor të Lexmark dhe na lini të jemi partneri juaj ligjor i besuar.


CONTACT US

ANA: 07435119343

ALDO: 07494181220

SANTJOLA: 07742877853

OFFICE: 0208 090 2488

 The Winning Box, Aquis House, 27-37 Station Road, Hayes, UB3 4DX

SHËRBIME TË REJA:

1. Mbështetja e Legjislacionit Civil:

Lundrimi përmes legjislacionit civil mund të jetë kompleks, por mos u shqetësoni! Profesionistët tanë të kualifikuar ligjorë janë këtu për t'ju udhëhequr në çështje të ndryshme të së drejtës civile. Nga mosmarrëveshjet e kontratave të drejtat pronësore, ne ju kemi mbuluar me këshilla dhe përfaqësim gjithëpërfshirës.

2. Ndhmë e dhembshur për të drejtën e familjes:

Ne i kuptojmë ndjeshmëritë e përfshira në çështjet e së drejtës familjare. Qoftë divorci, kujdestaria e fëmijës ose birësimi, ekipi ynë empatik është i përkushtuar për t'i zgjidhur çështjet familjare me kujdes, duke siguruar rezultatet më të mira të mundshme për ju dhe të dashurit tuaj.

3. Shërbime të fuqishme të mbrojtjes kriminale:

Kur përballeni me akuza penale, të kesh një mbrojtje të fortë ligjore është thelbësore. Avokatët tanë me përvojë janë njohës të mirë të ligjit penal dhe të përkushtuar për të mbrojtur të drejtat tuaja. Nga konsultimet ligjore të përfaqësimi në sallën e gjyqit, ne jemi këtu për të luftuar për drejtësinë tuaj.

ARBEN MANAJ

Editori i çeshtjeve te turizmit ne gazeten e madhe britanike "The Independent" te Londres, vazhdon t'i beje nje reklame te jashtezakonshme dhe mjaft te dobishme turizmit ne Shqiperi. Jo vetem permes shkrimeve te tij ne kete gazete, Simon Calder, (Sajmen Kallder), por edhe ne kanaline e dyte me te madh televiziv ne Britani, ITV, ai flet per pervojen e tij te fundit ne Shqiperi dhe cmimet mjaft te lira te qendrimit dhe udhetimit drejt Tiranes nga 7 aeroportet me te medha te Anglise dhe Skocise, dhe pese qyteteve me te medha ne ishull.

Rralle i besojne britaniket per ceshtjet e turizmit, pushimeve dhe fluturimeve jashte vendit sesa Simon Caldre, Editorit te gazetes The Independent te Londres, i cili vitet e fundit duket se ka rene ne dashuri me Shqiperine, jo vetem e shperfaqur kjo ne shkrimet e tij, por edhe daljet televizive, si kjo keto dite ne ITV, nder dy stacionet televizive me te medhe ne vend, bashke me BBC.

Ai se fundmi, ka qene ne Tirane dhe

thote se ka fluturuar per 50 sterlina dhe ka fjetur per 30 paund ne nje hotel ne qender te Tiranes.

Dhe e krahason kete me vitet 70-a, kur kishte blere me moshatare te tij afro 300 sterlina per nje pakete turistike permes ish-Jugosllavise, duke udhetuar, Londer- Zagreb- Titograd ose Podgorices se sotme, per ne

Ai thote, ne nje reklame masive per turizmin shqiptar, sic e cileson, Shqiperia e mrekullueshme, ka lene pas komunizmin ekstrem te vijes se asher dhe kontrollet rigoroze ne kufi, per te mirepritur ngrohesisht te huajt, fale ndihmes edhe te linjave low-cost, dhe pyet a ka hyre Shqiperia me ne fund ne stadin e nje destinacioni turizmi? Dhe pergjigjen ikona e gazetarisë britanike te turizmit e jep po vet, duke thene se ne 2024 Shqiperia do jete nje nga vendet me terheqese dhe i keshillon britaniket ta vizitojne kete vend dhe vende te tjera te Evropes Lindore.

ndersa britaniket e sotem s'kane

IKONA E GAZETARISE BRITANIKE PËR TURIZMIN SHQIPTAR



nevoje per vize shqiptare per 90 dite dhe e marrin ate ne aeroport, kundrejt asnje pagese, shqiptareve per te marre nje vize britanike dhe per te udhetuar me avjon drejt ishullit, u behet spektakel financiar dhe burokratik nga sektori i vizave ne Tirane, qe u kerkojne per nje aplikim, per nje njeri, rreth

425 euro, pa asnje garanci se do e marrin vizen dhe pa te drejte apelimi ne rast refuzimi, me kerkesa per paraqitjen e nje dokumentacioni voluminoz me kerkesa qe i kalojne caqet e normales.

Nderkohe, banoret e Ruandes ne Afriken ekuatoriale, paguajne 322 euro ose 100 euro me pak per vize britanike sesa shqiptaret, banore te nje vendi kandidat ne BE. Reciprociteti dhe proporcionaliteti ne kuptimin strikt te nocionit, edhe mund te mos kerkohej me Britanine, edhe pse Shqiperia i kursen shume financave britanike, permes zbarzjes se burgjeve angleze nga kriminogjenet shqiptar apo rikthimit ne Shqiperi te te gjithëve shqiptareve te ardhur ne Britani, fale marreveshjes Rama-Sunak, por nje lloj vetrespekti dhe dashuri me e madhe per shtetasit e tu, eshte i nevojshem, pasi ne fund te fundit, ashtu sic perfiton Shqiperia nga turizmi britanik, edhe shqiptaret qe udhetojne drejt ishullit, shpenzojne kur shkojne per turizem, me shume ne krahasim me te ardhurat e britanikeve.

REVOLTË

ASTRIT LULUSHI

Jul Cezari i dha fund një revolte të ushtarëve të tij duke thënë vetëm një fjalë. Ky incident i jashtëzakonshëm ndodhi gjatë një prej fushatave ushtarake të Cezarit në Gali (Franca e sotme) rreth vitit 52 pes. Ndërsa detajet specifike mund t'i nënshtrohen disa interpretimeve historike, ngjarja është regjistruar nga historianët e lashtë si Suetonius, Plutarku dhe Appian.

Gjatë kësaj fushate, ushtria e Cezarit u përball me një sfidë të rëndësishme. Usharët, të lodhur nga fushatat e tyre të gjera ushtarake, filluan të bëhen të pakënaqur dhe të shqetësuar. Ata dëshironin pushim dhe një shans për t'u kthyer në shtëpi pranë familjeve të tyre. Ndërsa zhgënjimi i tyre u rrit, ata organizuan një rebelim kundër komandantit, duke kërkuar që të shkarkoheshin nga shërbimi. Cezari, një strateg i shkëlqyer dhe udhëheqës karizmatik, e kuptoi peshën e situatës dhe nevojën për veprim të shpejtë. Ai mblodhi trupat para tij.

Duke qëndruar në këmbë mes murmuritjeve dhe trazirave, ai tërhoqi vëmendjen e tyre me praninë e tij komanduese. Pastaj, me një pauzë të llogaritur, shqiptoi një fjalë të vetme - "Quiritet?!" (Qytetarët?!)

Tani, mund të pyesni veten se çfarë është kaq e veçantë për këtë fjalë në dukje e zakonshme. Termi "quirit" ishte një referencë për qytetarët e Romës, pikërisht njerëzit për të cilët këta ushtarë kishin rrezikuar jetën e tyre dhe kishin luftuar beteja të panumërta. Duke thirrur identitetin e tyre si romakë, Cezari iu drejtua ndjenjës së detyrës, besnikërisë dhe patriotizmit. Efekti ishte i menjëhershëm dhe i thellë. Usharët, të cilët pak çaste më parë ishin në prag të rebelimit, papritur u kujtuan për besnikërinë e tyre të përbashkët dhe për kauzën më të lartë të cilës i shërbenin. Fjala "Quiritet?!" veprroi si një katalizator i fuqishëm, duke rindezur besnikërinë dhe përkushtimin e tyre ndaj gjeneralit të tyre dhe Republikës. Në atë moment, atmosfera u zhvendos nga ajo e mospajtitimit në unitet. Usharët, të

nxitur nga fjalët e Cezarit, hodhën armët dhe u gjunjëzuan para tij, duke shprehur pendimin e tyre dhe duke iu lutur për falje. Cezari, duke shfaqur zemërgjerësinë dhe mendjemprehtësinë e tij strategjike, pranoi faljen e tyre dhe i fali me dashamirësi, duke i kursyer nga ndëshkimi i rëndë.

Ky incident jo vetëm që tregoi aftësinë e Cezarit për të komanduar besnikërinë dhe respektin e trupave të tij, por gjithashtu theksoi kuptimin e tij të thellë të psikologjisë njerëzore. Duke përdorur një fjalë të vetme, ai hyri në vetëdijen kolektive të ushtarëve të tij, duke u kujtuar atyre identitetin dhe qëllimin e tyre të përbashkët.

Ndërsa ky tregim pranohet gjerësisht nga historianët, disa argumentojnë se mund të jetë zbuluar ose ekzagjeruar me kalimin e kohës. Megjithatë, ideja thelbësore mbetet e paprekur - aftësia e Julius Caesar për të shuar një revoltë me vetëm një fjalë flet shumë për aftësinë e tij drejtuese dhe aftësinë e tij të çuditshme për ta kthyer fatkeqësinë në triumf.

IVL Accountancy

SERVICES

PAYROLL SERVICES (INCLUDING CIS)
ANNUAL ACCOUNTS AND TAX RETURNS
CONFIRMATION STATEMENT
/ ANNUAL RETURN
VAT RETURNS
BOOKKEEPING
SELF-ASSESSMENT/ PERSONAL TAX
CLOUD ACCOUNTING
COMPANY INCORPORATION
(IF REQUIRED)
VAT REGISTRATION (IF REQUIRED)
PAYE REGISTRATION (IF REQUIRED)
CIS REGISTRATION (IF REQUIRED)
FINANCIAL REFERENCE
ETC

Broxbourne, EN10 6HS

Tel:

07749 590078

info@ivlaccountancytld.co.uk



Nese ju nevojitet nje llogaritar profesional mos hezitoni te kontaktoni INEN

07749 590078

PROVIDING CLIENT ADVICE & SUPPORT REGARDING FINANCIAL

HELP AVAILABLE AS A RESULT OF

COVID-19 CRISIS

(for companies & Self-employed)

We're contact lens savers too

From just 50p a day



You're better off with Specsavers





DAUT DAUTI

Disa rezultate të ADN-së, kanë krijuar një entuziazëm që i ka kapluar disa njerëz (shqiptarë). Në Kosovë del që prejardhja ilire është 80% kurse në Shqipëri 75%.

Një habi, e përzier me gëzim, se shqiptarët nuk kanë aspak prejardhje ‘turke’ e fare pak ‘romake’. Interpretimi i gabuar i historisë bënë që disa të krenohen me këto ‘fakte’. E vërtetë që shqiptarët nuk kanë prejardhje turke dhe romake për shkak se kjo nuk është e mundur praktikisht.

Romakët kanë qenë grup i vogël i njerëzve kurse turqit, duke qenë fis, edhe më i vogël. Prejardhja bizantine nuk ekziston fare. Në fakt, termi

bizantin është invencion që ka filluar të përdoret pas rënies së Perandorisë Bizantine.

Në aspektin gjenetik shqiptarët nuk kanë asgjë të përbashkët me romakët, bizantinët dhe otomanët. Perandoritë nuk shpërndajnë prejardhje gjenetike, por kulturë. Prandaj, shqiptari sot është ‘prodhim’ romako-bizantino-otoman. Nuk duhet të injorohet edhe kultura pansllave që te shqiptarët ka ardhur përmes komunizmit në të cilin sistem në Shqipëri kanë jetuar më gjatë se gjysmë shekulli kurse në Kosovë një shekull.

ADN-ja është me rëndësi për shkak se e tregon prejardhjen biologjike, por kjo gjë nuk është esenciale në formimin e ndërdijes kombëtare. Nacionalizmi, nga i cili doli kombi, është ideologji, sikur edhe religjioni.

Njerëzit kanë hyrë në bashkësi kombëtare me dëshirë, por në shumë raste edhe për shkak se nuk kishin rrugë tjetër. Popujt kanë qenë të detyruar të hyjnë në njërin apo tjetrin komb ashtu

ADN-JA E SHQIPTARIT



siç e kishin paraparë ideologët e nacionalizmit. Pra, kombi është krijesë artificiale kulturore e jo zhvillim natyral i bashkësisë me prejardhje të njejtë biologjike.

Para disa ditësh u bë lajm kur një shqiptar e vizitoi një serb në një fshat të Gjilanit. Shqiptari tha se e kishte kusheri serbin. E vërtetë. Por, në këtë

rast edhe pse që të dy kanë prejardhje të përbashkët ose ADN të njejtë, njëri është shqiptar e tjetri serb. Spiro dhe Anastas Bocarić, kanë qenë dy piktorë shumë të njohur serbë. Që të dy ishin nipa të Marko Boçarit të famshëm dhe me ADN të njejtë me Ali Pashë Tepelenën.

Por, pasardhësit e Marko Boçarit për-

funduan si grekë dhe serbë. Pra, ky është shembull se individët dhe shoqëria gjatë etapave historike janë zhvilluar në drejtime të ndryshme kulturore dhe kanë përfunduar në bashkësi poashtu të ndryshme kombëtare.

Sipas ADN-së, një pjesë e madhe e banorëve të Bosnjës dhe Kroacisë bregdetare dalin ilirë, por nuk janë shqiptarë.

Rast i kundërt është bota arabe që shtrihet nga Mauritania e deri te kufijt e Iranit. Tërë ky rajon flet arabisht (si gjuhë të parë) dhe kanë religjion (islam) të përbashkët. Por, prejardhja e tyre është tërësisht e ndryshme në aspektin biologjik (ADN). Ta zëmë, në Egjipti rreth 75% janë egjiptas sikur edhe në Siri që janë me prejardhje asiriane, por kulturalisht janë arabë.

Sipas ADN-së, kush do të ishte francez në Francë, anglez në Angli apo amerikan në Amerikë? Gati askush. Prandaj, ADN-ja në formimin dhe zhvillimin e kombit është e parëndësishme.

Apollonia Transport

TRANSPORT MALLRASH ANGLI - SHQIPERI SHQIPERI - ANGLI

SHQIPËRI

Tiranë - Durres-Elbasan-Berat
Fier-Vlorë-Roskovec-Ballsh

BRITANI

Londër - Birmingham
Manchester - Leeds - Luton

NA KONTAKTONI

UK: 00447429200952

AL: 00355682948843

AL: 00355694031009

TRANSPORT SHQIPERI - ANGLI

+44 7741 588799

+355 67 728 2828

SHQIPËRI

- Elbasan
- Tirane
- Shkoder
- Lezhe
- Laç
- Fushe Krujë
- Lushnjë
- Berat
- Poshnjë
- Belsh

ANGLI

- Londër
- Manchester
- Sheffield
- Leeds
- Birmingham
- Coventry
- Luton
- Oxford
- Northampton

Për oferta speciale ju lutem na kontaktoni në çdo kohë

Ju Faleminderit qe na besoni!

Dotech

websites

Akoma nuk keni një website?

Akoma nuk jeni regjistruar në Google



NA KONTAKTONI



020 7018 7929
073 4066 5946
078 5997 7545

Adresa e Zyrove
30 Avenons Road
London E13 8HT

ARMAND SHKULLAKU

SHTETI QË DREJTOHET NGA PARANOJA E EDI RAMËS

Vendimi i Edi Ramës, nëpërmjet Gjykatës së Lartë, për të mbajtur ende zvarrë deri në zgjedhjet e ardhshme çështjen e vulës së Partisë Demokratike, nxjerr në pah përsëri së fundmi një situatë absurde, gati skizofrenike. Sa më shumë krijohet bindja se Edi Rama është i plotfuqishëm dhe i pakërcënuar politikisht përballë një opozite të goditur e të përçarë, aq më shumë shtohen masat respresive ndaj saj, që shkojnë deri në asgjësim të plotë.

Ky shproporcion mes një pushteti të blinduar dhe goditjes frenetike ndaj opozitës, ngjan paradoksal për një mendje të shëndoshë. Jo vetëm veglat propaganduese të Ramës, por edhe vetë realiteti politik sot në Shqipëri, dëshmojnë epërsinë e regjimit mbi çdo faktor që do të mund ta rrezikonte atë. Të gjithë pranojnë se në kushtet aktuale, me opozitën e ndarë dhe të diskriminuar, me mjetet e pafundme të financimit, me kontrollin total mbi mediat, me bashkëpunimin në rritje me krimin dhe me përdorimin e hapur të drejtësisë së re, ndryshimi i pushtetit me votë mbetet thjesht një utopi.

Në korridoret e politikës thuhet se nëse bëhen zgjedhje sot, Edi Rama merr më së paku 90 mandate. Se mandati i katërt i tij as që mund të rrezikohet nga opozita që ka përballë, se ai është i qetë në mbretërimin e tij dhe se së paku për një dekadë tjetër nuk ka kundërshtar që mund ta rivalizojë.

E megjithë këtë tablo konfortuese për regjimin, mënyra se si ai po silltet me opozitën krijon përshtypjen sikur gjendet nën një kërcënim real dhe permanent. Logjika normale do të donte që në kushtet e sigurisë ku gjendet sot, Edi Rama, të paktën në dukje të bënte disa lëshime. Të lejonte fjala vjen komisionet parlamentare, të mos ndërhynte në përçarjen e opozitës, të



mos diktonte drejtësinë në procesin ndaj Sali Berishës dhe madje, siç predikojnë propaganduesit e tij, ta linte atë të merrte vulën e PD meqënëse i intereson elektoralisht ta ketë përballë,

Në fakt Edi Rama po bën krejtësisht të kundërtën. Ai duket si në ethe në luftën e përditshme për të asgjësuar çdo fije opozitarizmi ndaj regjimit të tij. Kjo përpjekje frenetike më shumë se sa nga logjika politike, duket e frymëzuar nga paranoja hipotetike se çfarë mund të ndodhë nëse ai një ditë mund ta humbi pushtetin. Sado e pamundur të duket kjo në kushtet e një regjimi, në mendjen e një njeriu të gjithëpushtetshëm shndërrohet në të vetmin anktë që, pak nga pak, dirigjon të gjitha veprimet e tij. Paranoja të tilla janë tipike pikërisht tek individët që arrijnë pushtetin absolut.

Nuk mund të ketë shpjegim tjetër veç paranojës, që ndonëse kontrollon gjithçka, Edi Rama kërkon të shkojë në zgjedhjet e ardhshme me dy liderët e opozitës në arrest apo në dyert e gjykatave. Jo vetëm kaq, por nëpërmjet gjykatave edhe atë opozitë që i ka mbetur e do ta mbajë peng për ta regjistruar në KQZ dhe kërkon ta zhveshë edhe nga e drejta më minimale që ekziston, përfaqësimi në Kuvendin e Shqipërisë.

Kjo është sikur të godasësh me top, dikë që ka vetëm një palë llastiqe. Një skizofreni e tillë mund të shpjegohet vetëm nga paranoja. Sepse sado i sigurtë të ndihet Edi Rama në pushtetin e tij, mjafton vetëm një "sikur" për t'ia prishur gjumin. Po sikur të mos jetë më kryeministër? Dhe këtu nis çmenduria për të shkretuar çdo gjë që

mund t'i dali përpara, nganjëherë edhe të vetët që i duket se ia kanë me hile.

A nuk ndihej i sigurtë Edi Rama edhe në zgjedhjet e vitit 2021? Sondazhet, anketimet, testimet e kalkulimet e nxirrmin fitues përballë Bashës. Ai ndryshoi kodin zgjedhor, ndaloi emigrantët të vinin të votonin, hodhi miliona euro të rindërtimit, mobilizoi bandat dhe keqpërdori policinë e administratën, e megjithatë mbeti një sikur. Po sikur PD dhe LSI të hynin bashkë në zgjedhje? Do të mjaftonte një hipotezë e tillë, pavarësisht se edhe në një rast të tillë ai do t'i kishte marrë masat, për t'ia shtuar anthin e nxitur paranojën.

Paranoja se ç'mund të ndodh me një lider absolut, nëse bie nga pushteti, shpesh është më e fortë se sa vetë sig-

uria që i jep pushteti. Individët të tillë nuk motivohen nga përdorimi i pushtetit për të arritur qëllimet e programit të tyre politik, por vetëm nga mbajtja e tij me çdo kusht si frikë për atë që mund të ndodhë nesër.

Prandaj sot institucionet më të rëndësishme të shtetit si Parlamenti, Gjykata Kushtetuese, Gjykata e Lartë, SPAK, Gjykatat e Posaçme, KQZ, Kolegji Zgjedhor, etj duken se janë vënë në shërbim jo thjesht të pushtetit të Edi Ramës, por të paranojës së tij. Ato po luftojnë çdo grimcë opozitarizmi dhe çdo të drejtë që do duhej të mbrohej në një shoqëri demokratike. Nga të drejtat e opozitës në Kuvend e deri tek mohimi i garës së barabartë në zgjedhje. Paranoja e Edi Ramës është rruga e çartur ku po ecën sot Shqipëria.

POROSISNI BANNERIN PER BIZNESIN TUAJ

Jepini diapazon biznesin tuaj

Te gjitha llojet

- PVC Banners
- Premium Roller Banners
- Pull Up Roller Banners
- Mesh Banners



Adresa e zyrave:
30 Avenons Road, London, E13 8HT

Na kontaktoni:
020 7018 7929
073 4066 5946



MIRANDA RIRA

SHPOPULLIMI MASIV, DRAMA MË E MADHE E SHQIPTARËVE NË SHEKULLIN XXI

Shpopullimi i Shqipërisë është një nga sfidat më të mëdha të shekullit në të cilin jetojmë. Sipas INSTAT, në 1 janar të vitit 2023, popullsia e vendit ishte 2,761.785 banorë dhe u zvogëluar në 1,1 % në krahasim me popullsinë e 1 janar, 2022. Piku më i lartë shfaqet në vitin 2022, ku u larguan nga vendi 46,460 rezidentë, ose 10 % më shumë se në vitin 2021. Po sipas INSTAT, çdo vit largohen nga vendi rreth 42,000 rezidentë shqiptarë, pra nga viti 2012 deri në vitin 2022, janë larguar nga Shqipëria plot 420,000 rezidentë. Me fjalë të tjera, përgjatë çdo viti të dekadës së fundit, një qytet me 40,000-42,000 banorë, u fshi nga harta e Shqipërisë, duke qenë se kjo është një shifër një popullsi demografike mesatare e qyteteve tona. Pra, bashki të tilla si: Mallakastra, Librazhdi, Mati, Cërriku, Belshi, Vau i Dejës apo Vora, të cilat kanë një popullsi rreth 40,000 banorë janë asgjësuar nga harta e Republikës së Shqipërisë, nga viti në vit. E shprehur më thjeshtë, çdo vit ne kemi humbur nga një bashki dhe kjo është ulëritëse. Kjo analizë induktive bëhet mbi të dhënat zyrtare të INSTAT, imagjinoni se sa e frikshme duhet të jetë situata reale në terren e shpopullimit demografik. Fatkeqësisht, do vijë një situatë e tillë kur nuk do të kemi jo vetëm banorë rezidentë, por as votues. Popullsia totale e Republikës së Shqipërisë në vitin 2022 ishte 2,7 milionë banorë, më një rënie 1.3 % krahasuar me vitin 2021.

Efektet më të mëdha të migrimit dhe shpopullimit janë më të dukshme në zonat dhe komunitetet rurale. I pamatë është shpopullimi i fshatrave në Shqipëri, nga veriu në jug të vendit ku dhjetëra e mijëra banorë kanë braktisur shtëpitë dhe trojet e tyre. Aq i madh është shpopullimi sa që ai po ndikon jo vetëm në shkretimin e fshatrave dhe zbrazjen e komuniteteve rurale, por edhe në tkurrjen e qyteteve të vogla e të mëdha, siç janë Elbasani, Dibra, Fieri, Shkodra, Patosi, Kukësi, etj. Një tregues i ekosistit të madh rural përgjatë viteve të fundit, është edhe rënia drastike e numrit të nxënësve në shkollat. Nga veri në jug, mund të gjesh shkollat të mbyllura ose me klasa kolektive të nxënësve nga klasa e parë në klasën e 6-të.

Shumë shkollat fillore në vend u mbyllën për shkak të mungesës së nxënësve dhe lindshmërisë së ulët në këto zona. Në fillim të vitit akademik 2023-2024, rreth 53,000 nxënës më pak u regjistruan në ciklin e mesëm. Kurse numri i studentëve të ulur në auditoret shqiptare ishte 220,000 më pak se 15 vjet më parë. Është alarmante rënia drastike e numrit të nxënësve dhe studentëve për një popullsi sa popullsia jonë. Shkollat në fshatin Shtëpez në bashkinë e Gjirokatrës kishin vetëm një nxënës, Diljani i cili ishte në klasën e parë dhe shoqen e vetme në klasën kishin gjyshen e tij 80 vjeçare që qëndronte



me të në klasën gjatë procesit mësimor. Në fakt, shpopullimi i një vendi është në simbiozë të plotë me migrimin human i cili është largimi i njerëzve nga një vend në tjetrin, nga një shtet në tjetrin.

Migrimi në vetvete tregon modelin e një bote që po ndryshon në aspektin politik, gjeografik dhe demografik. Migrimi sendërtohet në fakt në zemrën e ndryshimeve ekonomike, sociale e kulturore të shqiptarëve që nga vitet '90 e këtë. E ndodhur në qendër të Ballkanit, asnjë vend nuk është prekur përgjatë 3 dekadave nga emigrimi/ migrimi më shumë se Shqipëria. Pas rënies së komunizmit në 3 vitet e para, pra përgjatë viteve 1990-1993, rreth 200,000- 300,000 shqiptarë u larguan nga vendi duke emigruar kryesisht në Itali dhe Greqi. Rritja e popullsisë së Shqipërisë, ishte një ndër më të shpejtat në Europë gjatë komunizmit pasi u rrit nga 1.2 milionë banorë në vitin 1950, në 3.2 milionë banorë në vitin 1989. Kjo e dhënë është e shkruar në artikujt shkencorë të profesorit Russell King, i cili e ka studiuar Ballkanin dhe kryesisht fenomenin e migrimit të ballkanasve për 3 dekada me radhë. Pas rënies së komunizmit, pra duke filluar në vitin 1991 deri në vitin 2001, më shumë se 1/5 e popullsisë vendase, mendohet se ka lënë vendin apo ka migruar.

Gjatë regjimit komunist, për rreth gjysmë shekulli shqiptarëve iu mohojë të lëviznin jashtë kufinjve të vendit prandaj kushdo që ëndërronte apo

guxonte ta bënte këtë përndiqej, ekzekutohej ose internohej familjarisht. Gjatë diktaturës, mobiliteti nuk ishte i çrregullt dhe popullsia shënonte vetëm rritje demografike. Duke qenë se shumica e njerëzve jetonin në varfëri ekstreme, emigrimi drejt Italisë dhe Greqisë që ishin edhe afër gjeografikisht, u pa si një strategji efektive për përmirësimin e kushteve ekonomike të tyre. Deri në fund të dekadës së parë, mendohet se rreth 800,000 rezidentë shqiptarë u larguan nga vendi dhe jetonin jashtë kufinjve.

Fatkeqësisht, të dhënat empirike në lidhje me shpopullimet e para dhe migrimin e shqiptarëve janë shpeshherë kontradiktore dhe kaotike edhe për shkak se shumica e këtyre lëvizjeve ishin klandestine e për rrjedhojë të paregjistruara. Nuk ka asnjë dyshim, se pas viteve '90, shqiptarët kaluan eksodin e tyre më të madh. Shpopullimi masiv i shqiptarëve përgjatë 10 viteve të fundit, mund të konsiderohet si vala e dytë e një eksodi të parë të nisur në vitet '90. Ndryshimi substancial qëndron tek arsytet e shkaqet e këtij eksodi i cili në vitet '90- të ishte kryesisht për arsye ekonomike, pas një varfërie ekstreme të shqiptarëve, ndërsa sot nuk migrojnë vetëm shqiptarët që nuk kanë një punë apo një pagë mujore por edhe individë të kualifikuar të shtresës së mesme, specialistë e profesionistë të fushave të ndryshme.

Sociologët dhe ekonomistët flasin për faktorët shtytës dhe faktorët nxitës (push-pull factors). Faktorët shtytës

janë faktorët "negativë", ata që e shtyjnë dikë të largohet apo të emigrojë në një vend tjetër, siç mund të jetë: mungesa e shërbimeve të mira shëndetësore, klasa e korruptuar politike, skandalet e një qeverie të papërgjeshme, mungesa e ligjit dhe drejtësisë sociale, pra ku njerezit e ndiejnë se ligji nuk është i barabartë për të gjithë, por fryma e tij funksionon me dy standarte. Kurse faktorët nxitës janë faktorët "pozitivë" që e tërhoqi dikë të imigrojë në shtetin e tyre, siç mund të jenë: siguria e jetësës, shkolla më të mira për fëmijët, shpresa për një të ardhme më të sigurtë, të ardhura më të larta financiare, cilësia më e lartë e jetesës, etj.

Shpopullimi, është një nga dramat më të mëdha të shekullit XXI, pasi pasojat e tij ndihen dhe reflektohen në gjithë sektorët dhe nivelet e stratifikimit social. Ai reflektohet në sektorin e arsimit, të bujqësisë, të ekonomisë, të identitetit dhe kulturës lokale madje edhe në shëndetin mendor të shqiptarëve për shkak të atomizimit të mëtejshëm të familjes dhe shoqërisë.

Plakja ose moshimi i popullsisë është një tjetër problem që ndikon direkt në demografinë e një vendi. E gjithë Europa po vuan nga plakja e popullsisë, dhe mesa duket këtij trendi modern nuk i ka shpëtuar as vendi ynë. Moshimi i popullsisë shfaqet në nivele befasuese. Kështu për herë të parë në historikun e tyre, kishim disa qytete apo bashki ku numri i lindjeve ishte më i ulët se numri i vdekjeve, siç

është bashkia e Korçës ku gjatë vitit 2022 kishim 300 lindje më pak sesa numri i vdekjeve, ose 300 vdekje më shumë sesa numri total i bebeve të lindura. Mosha mediane në Janar të vitit 2022 ishte 38,8 kurse në Janar të vitit 2023 ishte 38,2. Kjo tregon se ka një trend rritës së moshimit të popullsisë, për shkak të numrit të ulët të lindshmërisë dhe numrit të lartë të migrimit të njerëzve.

Ajo që është shumë shqetësuese është raporti i vitit 2021 të Kombeve të Bashkuara ku citohet se nisur me këto ritme të shpopullimit deri në fund të këtij shekulli, pra në vitet 2090 popullsia totale e Shqipërisë do të jetë më pak se 1 milion banorë dhe do të jetë një popullsi e moshuar. Imagjinoni që përgjatë 100 viteve pra nga viti 1990 ku shënohet shifra më e lartë e popullsisë me 3.2 milionë banorë, popullsia e vendit në vend të dyfishohej, të rrudhet në 1/3 e saj, pra në më pak se 1 milion banorë. Këtu nuk kemi marrë parasysh të dhënat e fundit të Censurit, të cilat do të mbahen të fshehta nga qeveria shqiptare edhe për 6 muaj të tjerë e që me shumë gjasa do të jenë alarmante, sepse shpopullimi dhe emigrimi/ migrimi masiv i shqiptarëve gjatë viteve të fundit ka qenë i ngjashëm me migrimin e banorëve që dalin nga vendet e luftës. Deri atëherë le të shpresojmë, se do të ketë ende shqiptarë që do të zgjedhin të mos largohen nga vendi dhe shtëpitë e tyre.

KIM MEHMETI

Mbamendje është ajo që mbetet e shkruar e jo ajo që na e rrëfejnë gjyshet tona. Andaj edhe është thënë se të mençurit lënë pas vetes shkrime, e ata tjerët llafe, të cilat i merr era apo dalëngadalë zbehen dhe e ndryshojnë të vërtetën.

Edhe të vërteta për Ballkanin dhe ne shqiptarët në të janë ashtu siç ato shpeshherë janë përshkruar nga të tjerët. Për çka edhe ndodh që ne të habitemi pse intelektualët perëndimorë nuk i njohin të vërtetat tona, duke harruar se librat nga të cilat ata kanë mësuar për popujt e këtyre hapësirave, përfshi edhe shqiptarët, kryesisht janë të autorëve serbë.

Andaj ne shqiptarët duhet të bëjmë çmos që ta desërbizojmë të vërtetën për Ballkanin dhe për shqiptarët në të, duke e shqiptarizuar atë me të vërtetat tona. Gjë që mbi të gjitha duhet ta bëjnë historianit, por edhe të gjithë tjerët që mjet pune kanë penën.

Letërsia serbe është me përplot vepra që flasim për heroizmat serbe dhe 'barbarizmat' shqiptare, ndërkaq në letërsinë tonë nuk ka mjaftueshëm krijime as për mizorit e fundit serbe mbi shqiptarët e Kosovës.

Shteti serb ka investuar që këto vepra të përkthehen dhe të botohen në gjuhë të huaja duke e përhapur kështu të vërtetën për vetveten dhe të tjerët kudo ku kanë mundur.

Dhe kështu sot e kësaj dite shumë të vërteta për shqiptarinë bota i mëson nga autorët tjerë e jo nga ato shqiptarë. Madje edhe ne vet kemi filluar që fytyrën tonë kolektive ta shohim me syzat serbe dhe në mos më shumë të sillemi thujse çdo gjë e jona varet nga Beograd.

Me çka edhe u arrit ajo që pretendonte Serbia: që ne, për shembull, të shlyejmë nga mbamendja se sa herë revolucionarët dhe rilindësit tanë e kanë pasur



ngushtë në vendin e tyre, të kërkonin e gjenin strehim në Sofje, Budapest, Stamboll, SHBA e madje edhe në Egjipt, por thujse kurrë jo në Beograd.

Dhe jo vetëm aq, por 'zhurma' serbe neve na bëri thujse të harrojmë se përtej të vërtetave që i shpërndan për ne Beogradi, ka edhe të tjera të autorëve të njohur botëror që janë marrë me Ballkanin duke qëndruar me vite në këtë troje dhe duke lënë përshkrimet e veta të mbështetura mbi fakte.

Andaj ndoshta është koha e fundit që ato vepra të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të sillen nëpër bibliotekat tona që kështu ta begatojmë mbamendjen tonë për vetveten dhe të tjerët rreth nesh.

Me çka edhe do e kuptojmë se si u bë të harrojmë, për shembull, se Sanxhaku

është tokë shqiptare dhe në të është folur shqip deri vonë. Apo si u bë dhe harruam që pronarët e tokës përcaktohen nëpërmjet asaj se cilën gjuhë flasin të gjallë që e banojnë atë.

Ndër autorët që kanë shkruar për Ballkanin është edhe Johann von Hahn i cili gjatë udhëtimit të tij të parë nga Beogradi deri në Selanik, gjatë vjeshtës së vitit 1858, merret edhe me të dhëna etnografike dhe gjuhësore mbi rajonin e lumit Morava.

Kështu në veprën e tij "Reise von Belgrad nach Salonik", 1861, pasqyrohen të dhëna etnografike dhe gjuhësore mbi shpërndarjen e vendbanimeve në rajonin e Moravës sa i përket përbërjes etnike të popullsisë e që përcaktojnë kufirin gjuhësor midis shqipes, bullgarishtes dhe serbishtes në vitet 50-ta të

shekullit XIX si dhe pasqyrojnë përbërjen etnike të shumë vendbanimeve sipas rajoneve, e që kanë përfshi pellgun e Toplicës me 84 katunde shqiptare, 32 katunde serbe, 20 katunde bullgare, 11 katunde shqiptaro-serbe dhe 10 katunde bullgaro-shqiptare; pellgun e Pusta Rekës me 17 vendbanime shqiptare, 3 katunde bullgare, 1 katund serb dhe 3 katunde bullgaro-shqiptare; pellgun e Jabllanicës me Medvegjen me 33 katunde shqiptare dhe 30 katunde bullgare; pellgun e Veternicës me 26 katunde bullgare, 12 katunde pa të dhëna për etninë, 7 katunde shqiptare; pellgun e lumit të Moravës së Sipërme me 65 katunde bullgare, 49 katunde shqiptare, 11 katunde serbe, 19 katunde shqiptaro-bullgare dhe 7 katunde shqiptaro-serbe.

I kësaj natyre është edhe punimi i Gus-

tav Weigand me titull "Ethnographie von Makedonien" 1924), në të cilën përcaktohen kufijtë gjuhësorë mes popujve të këtushëm e ku ai shkruan se "Nga mali Gramos, diku te Dardha, kufiri gjuhësor shqiptar bën një kthesë të mprehtë kah lindja përfaqësisht te Liqeni i Kosturit dhe pastaj shkon në veriperëndim përmes skajit jugor të Grykës së Prespës deri te skaji jugor i Liqenit të Ohrit, bregu perëndimor i të cilit nga Pogradeci deri te Piskupi është shqiptar; pastaj ai (kufiri) ndjek qafën e Malit Mokra pikërisht në veri deri te Boroveci, rreth 12 km në veri të Strugës"

Një përshkrim shumë të hollësishëm për zonën e kontaktit gjuhësor midis bullgarishtes dhe shqipes ka dhënë edhe studiuesi rus Afanasij Selishçev. Ai ka marr pjesë në ekspeditën ruse shkencore në këto troje gjatë vitit 1914. Shkrimet e tij pasqyrojnë dialektet bullgare në këto hapësira, duke i përcaktuar zonat e kontaktit midis shqipes dhe bullgarishtes.

Dhe nuk janë vetëm këta studiues që kanë lënë vepra të shkuara për gjuhën shqipe, për shqiptarinë dhe ndërlidhjet e saja me të tjerët. Ka edhe plot vepra tjera të kësaj natyre që duhen marr nëpër duar nga studiuesit tanë dhe që duhet përkthyer në gjuhën shqipe me çka ato do e plotësojnë mozaikun e të vërtetave për ne dhe të tjerët rreth nesh. Edhe atë jo me pretendime të tregohemi atë që nuk jemi, por përkundrazi që të qartësohet se cilët jemi.

Më në fund duke mbajtur mend të shkuarën tonë ne edhe do e shohim më qartë sa jemi të gatshëm që të mos lejojmë ajo të na përsëritet dhe si të ruajmë miqësitë me popujt miq e si t'u kundërvihemi atyre që i ndjellë gjaku shqiptar, atyre që duan të na shfarosin ngaqë na ndjejnë si pasqyrë ku e shohin fytyrën e vet të vrastarit dhe vetveten si zaptues të tokave tona.

POROSISNI kartat e biznesit tuaj

Për çdo konsultim mund te vini në çdo kohë në zyrat tona
Na kontaktoni:

020 7018 7929 073 4066 5946 078 5997 7545

Adresa e zyrave: 30 Avenons Road, London, E13 8HT



AKOMA NUK KENI NJE WEBSITE?

Akoma nuk jeni
regjistruar në Google?

Dotech
website 

The **Albanian** 



**"If your business
is not on the internet
then your business will
be out of business"
BILL GATES**

Krijo websitin tënd!

- Business Cards
- Banners
- Video Marketing
- Logos
- Etc



020 7018 7929
073 4066 5946
078 5997 7545

**PËR ÇDO KONSULTIM
MUND TË VINI NGA
ZYRAT TONA**

Adresa e zyrave
30 Avenons Road,
London E13 8HT

ANDI BUSHATI

Dokumentat e reja, të botuara nga shqyrtimi që Zëri i Amerikës i bëri dosjes McGonigal, përforcojnë edhe më shumë bindjen e një skandali të financuar me para në dorë nga Tirana, për të shkatëruar opozitën vendase. Në zbulimet e panjohura më parë, citohet një agjent i FBI-së, që i shpreh dyshime shëfave të tij, se ç'vlerë ka të hetojë këtë çështje, kur insitucioni nuk ka kapacitete për t'u marrë me hetime më të rëndësishme që kërcënojnë sigurinë kombëtare të SHBA-së. Pra, sipas tij, kjo është një dosje e sitisur dhe e pado-bishme, e hapur gjoja për të hetuar parregullsitë, në deklarimin e financimeve të amerikanit Nik Muzin, nga Lulzim Basha, i cili sipas dyshimeve paskësh marrë para ruse.

Tezën se mbrapa këtij makinacioni ka diçka të errët e mbështesin edhe dy fakte të tjera. Së pari, vetë ish agjenti tashmë i dënuar me 30 muaj burg, Charles McGonigal, pranoi para gjykatës se ai ka ndikuar për ta çuar përpara këtë dosje. Së dyti, ashtu sikurse theksojnë prokurorët amerikanë, kjo flluskë sapuni u shua, sapo McGonigal doli në pension dhe dosja u mbyll.

E thënë kështu, historia duket shumë e thjeshtë: ajo e një qeverie që me para të zeza blen një zyrtar të SHBA-së, për ta përdorur për nevojat e saj. Nuk ka rëndësi se ky është agjenti më i rëndësishëm i FBI-së, i korruptuar ndonjëherë. Nuk ka rëndësi as se, kjo bëhet nga vendi më i varfër anëtar i NATO-s. Këto janë krejt të papërfillshme në raport me makinerinë manipulative që kjo blerje e thjeshtë vuri në punë më pas.

Për ta kuptuar atë më mirë i'a vlen ti rikthehem edhe njëherë, shkurtimisht kronikës. Ajo na tregon se, në gusht 2017, McGonigal i kërkoi borxh, shqiptaro-amerikanit Agron Neza. Ai bëri gjënë që dinte të bënte më mirë për ti gjetur paratë. E solli agjentin e FBI-së që në shtator të takohej, në kryeministri, me Edi Ramën. Menjëherë pas kësaj ish agjenti mori të paktën 225 mijë USD.

Tashmë i paguar ai u kthye në nëntor të Shqipëri. Menjëherë pas kësaj filloi dhënia e marerialeve me burim nga kryeministria, për "paratë ruse" të Bashës dhe PD.

NJË FABRIKË GJIGANDE MANIPULIMI



Ashtu sikurse pohon vetë, McGonigal ndikoi në hapjen e hetimit, përmes materialve që i serviohin nga Neza dhe këshilltari informal i kryeministrit, Dorian Duçka. Kulmi i kulmeve, ky i fundit i paguante edhe dëshmitarët që dëshmojnë për FBI-në lidhur me këtë ngjarje dhe kjo gjë i mbahej e fshehtë institucionit. Në shkurt 2018, qëllimi u arrit dhe FBI hapi hetimin zyrtar kundrejt lobistit të Bashës.

Pra, deri këtu, kemi thjeshtë fabulën e një ish zyrtari amerikan të korruptuar nga qeveria e një vendi partner.

Sa do e rëndë dhe e pisët që të duket, kjo përbën vetëm majën e ajsbergut. Sepse nga ky pazar banal u prodhua një mostruozitet monumental, që krijoi një realitet paralel krejtësisht të gënjeshtërt.

Pa kaluar as katër pesë javë nga

hapja e çështjes përmes trysmimit të McGonigal, në një revistë amerikane, "Mother Jones", të padëgjuar deri më atëherë në Shqipëri, rodhën të dhënat për një artikull që akuzonte opozitën tonë se financohej me para ruse. Detajet e këtij shkrimi i përdori edhe prestigjiozia New York Times që e rimori këtë temë.

Qaq u desh që gazetatat dhe televizionet e financuara me paratë e inceneratorëve, të shndëronin në kryetëmë rrezikun që po i kanosej sigurisë kombëtare, nga financimet e Kremlinit. Politikanët në pushtet, nuk e hiqnin nga goja këtë rrefren, sa herë shfaqeshin përpara kamerave.

Për të kuptuar atmosferën që mbretëronte në vend është mirë që të shikohet një deklaratë, sa debile po aq dhe qesharake, e Elisa Spiropali, nga selia e PS, të cilën e postoi edhe Edi Rama në Face-

bokun e tij (shih videon poshtë). Në këtë dallëdi spiropalizuese, Elisa fliste për një situatë të rëndë, të errët për vendin, ku forca armiqësore po ndikonin politikën dhe parlamentin.

Por, manipulimi nuk përfundoi tek fjalët. Në lojë hyri prokuroria e Tiranës, që hapi dosjen e financimeve ruse.

Më tej shkoi edhe ish ambasadorja Yuri Kim, që gjatë një takimi me dyer të mbyllura, e përdori në mënyrë evazive këtë pandehmë, për të mbajtur gjallë fabulën e një opozite që nxinte realitetin dhe i bënte keq vendit, si pasojë e pagesave që i vinin nga Rusia.

Pra si konkluzion, kjo nuk është thjeshtë historia banale e blerjes së një agjenti, sado i rëndësishëm që të ketë qenë ai, por pasqyra se si ky akt korruptiv, vuri në lëvizje

përmes lobimit, media ndërkom-bëtare dhe kombëtare, politikanë e parti lokale, drejtësinë vendase dhe diplomatët e huaj.

Dhe të gjitha këto për çfarë? Për një dosje, që pasi u kap me preshë në duar, McGonigal e pranoi se e kishte shpënë vetë përpara dhe që u mbyll porsa ai doli në pension. Për një çështje që siç treguan dëshmitë e fundit të Zërit të Amerikës edhe zyrtarët e FBI-së e dinin se nuk kishte asnjë vlerë.

Prandaj, nëse për SHBA-në, dosja e McGonigal është e rëndë, pasi ajo tregon se një shtet brekëgrisur arriti ti korruptojë agjentin më të lartë të rekrutuar ndonjëherë, për Shqipërinë ajo është disa fish e tillë. Për ne, ajo nuk dëshmon thjeshtë një blerje me para në dorë, por fabrikën oruelliane të manipulimit, që e bën këtë vend të jetojë në një realitet paralel.

GENC POLLO

1-Dy hollandezët e kulturës së shtetit ligjor!

Në 7 maj 2018 deputetët hollandezë Peter Omtzigt e Stieneke van der Graaf (përkatësisht të partive CDA e CU) u çuan nga tryeza në restorantin Estia në Tiranë, ku ambasada e tyre kishte shtruar një drekë për delegacionin parlamentar nga Komisioni i Çështjeve Europiane që vizitonte Shqipërinë dhe për kolegët shqiptarë të komisionit homolog.

Dy deputetët u kthyen mbas dhjetë minutash në tryezë pasi mbajtën shkurt një konferencë shtypi në oborr. Mbas drekës ne hapëm telefonat pamë që në portale dy deputetët ishin bërë lajm i parë. Ata, duke folur në emër të delegacionit parlamentar, thanë se kishin ardhur për të verifikuar në vend se sa i kishte përbushur Shqipëria kushtet për çeljen e negociatave për anëtarësim në BE. Para medias por edhe në takimet e tjera ata kishin ngritur me shqetësim mungesën e Gjykatës së Lartë dhe asaj Kushtetuese, shkrirjen arbitrare të Prokurorisë së Krimeve të Rënda nga Prokurorja e Përgjithshme AM, mbrojtjen e paduhur nga mazhoranca të ish ministrit të brendshëm të akuzuar për trafik droge, mosekstradimin në Itali të vëllait të Ministrisë të Brendshme i dënuar gjithashtu për trafik droge, etj.

Kundërsulmi nuk vonoi: Kryetari i Kuvendit G. Ruçi kujtoi se në regjimin komunist shqiptarët nuk njihnin drogë e korrupsion e i mësuan ato kur u hapën kufijtë me Europën; e megjithatë në Eurovision e Champions League shqiptarët shkëlqejnë më fort se hollandezët. Më vonë KM Rama, duke dashur të presë drutë pak më hollë, theksoi se misionet faktmbledhëse si ky i hollandezëve janë punë koti sepse faktet i kanë mbledhur e studjuar ata mijëra ekspertë të Komisionit Europian që janë më të mirët në botë dhe kanë konkluduar pozitivisht. E për të mos e lenë krejt vetëm kolegun kryeparlamentar Rama shtoi se ata dy deputetë vijnë në Tiranë se bëhen lajm kryesor pasi në vendin e tyre nuk i begenis kush me kamera e mikrofonë.

Lexusi shqiptar tashmë nuk e ka të nevojshëm një shpjegim mbi deficitin e madh të Edi Ramës në kuptimin e praktikën e demokracisë. Megjithatë episodi i mësipërm ilustron funksionimin e ndarjes së pushteteve, një koncept anatomë për satrapët modernë dhe mtonjësit ballkanikë për këtë status. Për çështje të rëndësishme e sensitive parlamentet jo vetëm dëgjojnë qeverinë e tyre dhe lexojnë raportet e burokracisë shtetërore por edhe verifikojnë vetë në terren përmes takimeve me palët e përfshira vërtetësinë e saktësinë e fjalëve të ekzekutivit. Kështu ndodhi p. sh. me “9 kushtet e Bundestagut” të iniciuara nga grupi parlamentar i partisë së kancelares Merkel apo edhe me rezoluta të ndryshme të Parlamentit Eu-

MBI DUKJEN E THELBIN PARLAMENTAR PËRMES PRIZMIT TË PALËVE TË TRETA



ropian të cilat vunë seriozisht në dyshim pohimet e Komisionit Europian se Shqipëria i kishte përbushur kushtet e kërkuara.

Dhe në fund të fundit zyrtarizimi i kushteteve nga BE (Këshilli Europian, pra shtetet anëtare) ishte një trysni pozitive për përbushjen reale të kushteve dmth normalizimin deri diku të funksionimit të shtetit shqiptar. Kjo nuk do të thotë se punonjësit e Komisionit Europian nuk i kanë parë e shënuar faktet. Por nën drejtimin e funksionarëve të komprometuar si Vlahutin apo të njëanshëm si Mogherini objektivitetin e raportit nuk e shpëton dot as eksperti më i aftë e as burokrati më korrekt.

Një shembull që Edi Rama do e ketë përzemër është Instituti Ndërtimit: drejtori AH pas një inspektimi të posaçëm konkludoi se ndërtesa e Teatrit Kombëtar ishte e rrezikuar nga goditjet sizmike edhe pse inspektimi i rregullt dy vjet më parë kishte konkluduar të kundërtën (çka e verifikoi edhe tërmeti real asokohe).

2-Dy hollandezët e kulturës së

imazhit të instagramit tok me një shqiptar

Në restorantin Estia biseda vazhdoi edhe pas konferencës së shtypit me sqarimet e deputetëve vendas ku pala rilindiste, për t'a thënë me Nolin, “fryn bulcitë e trumbeton se katrani zbardhëllon” ndërsa në të palës opozitare ofronim akrobacinë logjike se “kushtet nuk janë përbushur por negociatat lipsen të çelen sepse ato ndihmojnë që të përbushen kushtet”. Në një moment deputeti hollandez Kees V. (i partisë D66) doli disi nga tema dhe kërkoi shpjegime për rrëmujën në parlament gjashtë muaj më parë duke shtuar se pamje të tilla me të shtyra e tymuese nuk ndihmonin avancimin drejt BE. Unë ju gjegja shkurt se mbledhjet e Kuvendin Popullor të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë kishin qenë shumë më të qeta por megjithatë kjo nuk kishte ndihmuar fare që të vendosej ndonjë farë raporti me Europën. Mbas një të qeshure të shkurtër biseda u kthye në shinën e “katranit zbardhëllues” dhe “të çeljes që të përbushen”.

Zoti Kees C. e pati fjalën për rrëmujën

e shkaktuar nga opozita për të penguar apo të paktën protestuar kundër votimit jokushtetues e antiligjor për të emëruar A. Markun si Prokurorë e Përgjithshme. Por Kees C. as nuk e dinte se cili ishte shkaku i rrëmujës, as nuk dinte se ky shkaku solli pasojë që delegacioni i tij i ngriti si shqetësime për shtetin ligjor (shkrirja arbitrare të Prokurorisë së Krimeve të Rënda) dhe madje as nuk kishte kureshtje t'i mësonte ato. Atij i mjaftonte një pamje e qortueshme dhe kaq.

Me gjasë nuk do t'i shënoja këto kujtime të para pesë viteve por sepse u bë një postim në X (ish Twitter) i një hollandezi tjetër. Zoti Reinout Vos, ambasador i Vendeve të Ulta në Tiranë, shkroi të mërkurën (17/01) “skene e papranueshme sot në parlament”. Në fakt skena ku dy burra deputetë që i gërmusheshin e i përbysnin mikrofonin një deputeteje grua teksa kjo kryesonte një mbledhje komisioni, ishte shume e pabukur për këdo në Shqipëri, Hollandë dhe Europë. Fakti që dy deputetët ishin të opozitës reale e që deputetja i përkiste opozitës jeniçere dhe që në atë mo-

ment po sillej si e tillë nuk ndryshon gjë tek sjellja e imazhi negativ. Por vetëm me këtë vëzhgim pa e shpjeguar kontekstin e shkaqet e skenës druaj se mbetemi tmerrësisht të përceptë.

Si skena me zonjën deputete ashtu edhe trazira në çdo seancë plenare janë reagim ndaj një seri shkeljesh të rënda të kushtetutës e të ligjit nga mazhoranca gjatë v2023 për të refuzuar të drejtat e opozitës parlamentare. Këtu përfshihen komisionet hetimore të kërkuara, përfaqsimi i opozitës në komisionin e reformës zgjedhore, zbatimi i vendimit të Gjykatës Kushtetuese për mandatin e një deputeti dhe paraqitja e qeveritarëve në interpelancë. Raporti i Komisionit Europian i nëntorit “Albania 2023” i listonte këto raste si keq-funksionim i parlamentarizmit dhe thyerje e ligjit. Ata që nuk janë informuar për këtë nga debati publik e konfrontimi parlamentar me siguri e kanë lexuar në raportin e Brukselit. Dhe është në tagrin e gjithsecilit të formojë një opinion se çfarë është më e dëmshme dhe e qortueshme mes dhunimit të parlamentarizmit e pluralizmit në njërin anë dhe në anën tjetër reagimit ndaj këtij dhunimi (edhe me mjete jo konvencionale dhe shpesh jo estetike mbasi janë shterruar udhët institucionale).

Një opinion duket se e ka korrespondenti i agjensisë së lajmeve Associated Press në Tiranë Ll. S. i cili ka raportuar periodikisht që nga shtatori për situatën në Kuvend. Që në fillim lipset të thuhet se raportimi ka qenë përgjithësisht i ballancuar e kanë vënë në dukje se protesta e opozitës ka filluar para akuzimit nga SPAKu të liderit të opozitës. Por fjalja kyç është se “rrëmuja në parlament mund të jetë pengesë për reforma të nevojshme mbasi BE ka pranuar të fillojë harmonizimin e legjislacionit shqiptar me atë të BE”. Dhe pyetja e arsyeshme e gjithkujt do të ishte po shkeljet e Kushtetutës dhe të Rregullores së Kuvendit, siç e vë në pah Komisioni Europian a janë pengesë? Përpjekjet për t'i korigjuar ato a janë një ndihmë? Pa u ndalur në faktin se mazhoranca po miraton ligjet si don edhe per katër minuta edhe me zoom.

Përtej çështjeve të Shqipërisë prej kohësh ka një trend kulturor global që fokusohet në imazhin efemer e në titullin bombastik pa i kushtuar vëmendje përbajtjes e pa shprehur interes ndaj thelbit të gjësë. E njohur edhe si kultura e imazhit të instagramit në rastin tonë nuk shfaqet tek opionistët e njëanshëm e mediat shërbestare por edhe tek ndërkombëtarë që flasin për pasojën e heshtin për shkakun.

AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE?

Akoma nuk jeni
regjistruar në
Google?!

**Për çdo
konsultim
mund te vini
në zyrat tona**

The **Albanian**

**Adresa e zyrave:
30 Avenons Road
London E13 8HT**

Na kontaktoni:

**020 7018 7929
073 4066 5946
078 5997 7545**



**NE MUND T'U
NDIHMOMJME EDHE ME:**

- Business Cards
- Logos
- Invoices
- Posters
- Quotations
- Banners
- Flyers
- Video Marketing
- Online Marketing
- Etc

SONILA MEÇO

Bota kjo është, nuk u bë në një ditë. E padrejtë, e poshtër, e pabarabartë, meskine, cinike, e ashpër, e pacipë, mizore.

Nuk ta jep dot as konfirmimin e as shpërblimin e merituar, sipas kutit tënd. Edhe kur je keq e s'gjen dot derman, por edhe kur je mirë, i privilegjuar e sheh se çfarë ndodh rreth teje mbushesh me ndjenja faji a thua ky është krim i një lloji tjetër.

Bota është kjo dhe nuk ka veç një "sepse", as njëqindmijë. Mediokrit, mizerjet, maskarenjtë, kriminelët, hajdutët, imoralët, të pabesët, injorantët nga aty ku e sheh e gjykon botën janë të shpërblyerit e mëdhenj. E të vjen plasje, zeheri në stomak të shteron çdo energji.

Por kjo perspektivë ndryshon në sekondë nëse të bie rruga drejt një spitali, funerali, azili. Të ngjan halli e paqetësia jote një dromcë në oqeanin e vuajtjes dhe torturës njerëzore. Pyesni një mjek, një kujdestar, një nënë, që ka humbur fëmijën, një psikolog a një vullnetar në vende lufte. Si do t'ju ngjajë ajo padrejtësi e pamerituar e një rroge, e një vendi pune, e një intrige pas shpine, e një fyerjeje, e një përgojimi, e një vjedhjeje.

Por kjo nuk e zhbën as hallin tim të vogël në dukje e as drobitjen e tmerrshme të kujt po provon ferrin në tokë. Të dy dramet, pavarësisht përmasës janë të dhimbshme, shpirti i secilit e di, sa kohe përballet me provën. Ama, nuk ka shërim thjesht duke klithur drejtësinë, paqen, barazinë, mirënjohjen, ndershmërinë, shpërblimin shpirtëror e material të dëshiruar, merituar. Duke iu drejtuar botës me gisht.

Sepse kësi katandisje morale, kjo zhytje e thellë moçalore veprash nuk shpëtohet thjesht duke thirrur, por edhe duke vepruar.

Dhe vijmë tek thelbi... A mundet të veprosh i ngulfatur gjer në fyt? I lodhur, i zhgënjyer, i rraskapitur, i pashpresë? A mund ta bësh i vetëm edhe në mos qofsh gjer në zgrip, por duke mos e duruar botën rrotull në konsum ordiner moral?

Më është dashur shumë, jo pa mundim, në një proces ndërgjegjësimi të gjatë, të vështirë, sfidues, strapacues, duke hyrë e dalë nga vetja me mijra herë: nuk zbraz dot asgjë nga një enë bosh. Duhet mbushur ena. Vetja.

Si?
Ta njohësh e pranosh se kjo është bota e madhe, ku je gjithnjë e më i vogël për ta shndërruar gjithë padrejtësinë karmike, me brezni. Është drobitëse të ndihesh i pafuqishëm për ta bërë, e di, ma di shpirti, trupit. Nga njëra anë të vjen plasje kur e di se çfarëdo bën nga pozicioni yt, puna, edukimi, formimi, angazhimi shoqëror nuk mjafton e ngjan si energji çuar dëm se e keqja funksionon me megawat. Mandej ndihesh si në faj kur sheh ç'mënxyra kalojnë njerëzit e ti anko-



hesh për ato që të ndodhin ty, njeriut të punësuar, me formim, njohje, të ardhura më të mira, me duar e këmbë, privilegje, të fortë prej natyre, me sado thika ngulur shpine.

Ndaj nis me pranimin dhe njohjen e ndryshisë së botës, pa fatalizëm. Të të gjitha mëkatëve të saj. Përsëritjes korrekte të maskarallëkut, degradimit, degjenerimit, zvetnimit. Por edhe njohjes së vetes, si vëzhgues i brendshëm dhe i jashtëm i saj. Sepse vetëm kësaj do mundesh të kanalizosh sasinë e duhur të energjisë në gjërat, që mund të ndryshosh. Jo thjesht duke i thirrur, mallkuar, sharë, gjykuar, dënuar. Por në ndryshimin sado të vogël, aty ku mund t'ja dalësh, në atë copëz habitati, për aq njerëz, në atë cep bote. Kjo jep paqen për vuajtjen e thellë njerëzore, intelektuale, morale të kujtdo sheh si rrokopuja e një bote të çartur tenton të shqyejë rrënjët aq

shumë të investuara të secilit edhe me breza.

Por kjo kërkon të nisësh nga vetja, të jesh mirë me të, të kujdesesh për trupin tënd, për shëndetin mendor, të ushtrohesh, të ushqehesh mirë, të gëzosh kënaqësitë e vogla të jetës me të shtrenjtët e tu, të pushosh, të zgjedhësh ç'të shohësh e të lexosh, të kontrollohesh për atë dhimbjen bezdisëse, të dëgjosh mendje të ndritura, të stakohesh për ca kohë gjersa të ndjesh se kupa jote u mbush bash mirë e prej saj mund të nisësh të "zbrazësh" për të ndryshuar gjërat, për të zhbërë padrejtësitë e botës, për të luftuar betejet morale, shoqërore, për të ndihmuar të pamundurit, ata pa privilegjet e tua, të jesh për të nëpërkëmbur, të ngresh platformë për kë zë s'ka, të krijosh lëvizje, të prodhosh rezistencë.

Truri ynë është krijuar të dallojë më

së pari të keqen, si strategji vetmbrojtëse. Por mu për këtë duhet vullnet e durim me pa të mirën, pozitiven sado të vogël, me qenë mirënjohës, me e vlerësu veten për aq ndikim, sado të vogël për mirë tek tjetri. Pa e shkatërru veten me idenë se jemi të pamundur me e ndryshu të keqen e madhe. Nuk e ndryshojmë dot, ama e përballojmë më mirë, i japim një dorë kujt të mundemi, flasim e veprojmë në komunitete të vogla pa patur nevojë t'ja ulërasim botës e të shqyejmë veten për ca më shumë ndjekës në rrjetet sociale. Se po nuk ma diti bota, nuk ka vlerë. Jo or jo! Bota s'do t'ja dijë si e tërë, ama del nga ajo hulli e padritë trishtimi se jemi të pafuqishëm për të ndjerë, ndryshuar, shijuar të mirat e kësaj bote.

Me këtë filozofi e gjendje fizike do mund të përballojmë edhe tragjeditë përreth, do trashim lëkurët të rezisto-

jmë, do nisim të bëjmë sa mundemi e do mësojmë të çmojmë botën e vogëlth, që zgjodhëm e u rrekëm ta bëjmë më të mirë.

Dhe ndonjëherë duhet bërë paqe me idenë se jo thjesht fjala, por veprimi ndryshojnë gjërat dhe se kjo kërkon kujdesin për veten në radhë të parë. Imagjinoni një kor, ku të gjithë të ndërgjegjësuarit, të fortët nga natyra, të paepurit, të formuarit, intelektualët, të drejtët të këndojnë në nota të larta pa pushim. Do vijë momenti të ngjiren e s'do ketë mbetur kush të këndojë më e tingujt e "zgjimit" shoqëror do shuhen. Ndaj mes tyre, pak tërheqje herë pas here, për pak më shumë kujdes për veten para se t'i jepesh korit do ndërtojë "muzikë" të pashtershme.

Ndërgjegjësim do kjo situatë kaq e ndërlikuar, nuk ndërtohet bota, duke shkatërruar veten!

NJË KËNDVËSHTRIM EKONOMIK PËR VËLLAIN E MADH!

IRENA BEQIRAJ

Mjafton të hapesh Facebook-un edhe nuk u shpëton dot lajmeve nga Vëllai i Madh [Big Brother]. Jul Deda paska qenë kundër këtij formati, por tani është futur si konkurrent. Mirë ka bërë. Madje, shumë mirë, “do të thosha unë”, se “vetëm gomari nuk ndryshon mendje”! Drini Zeqo la shtëpinë për arsye familjare. Kaq mjaftoi që disa nga banorët që kishin më pak se një javë që jetonin me të, t’i kaplonte një dëshpërim i thellë!

Çfarë drame! Nuk po bëj asnjë koment për fjalorin edhe batutat e Roza Latit në publik, për shkak të konfliktit të interesit. Sepse, edhe ajo është nga Vlora, njësoj si unë. Por, sado fakte të rreshtojmë në rrjetet sociale e nëpër tavolina, e sado te distancohemi nga këto formate, një gjë duhet ta pranojmë: të ashtuquajturat spektakle të realitetit [reality show] sot janë ngurtësuar e kthyer në institucionin më të suksesshëm në industrisë e argëtimit.

Jul Deda, sot konkurrent, në vitin 2015 e pranonte se efektet e kësaj rrënjësije nuk janë inkurajuese. Shfaqjet e këtij tipi të spektaklit ndihmojnë në normalizimin e mizorisë, armiqësisë, mediokritetit, pabesisë, vulgaritetit, injorancës, mashtrimit, duke i shpërblyer njerëzit që i përdorin këto tipare. Madje, edhe duke kurorëzuar përdoruesin më të mirë të tyre.



Fakti që ato janë sot emisionet më të ndjekura, shkon më tej sesa arsytimi që ato paraqesin një projekcion të moçalit shoqëror. Po të analizojmë modelin ekonomik që zhvillohet brenda tyre, ato janë produkt i pastër i ekonomisë së lirë e të parregulluar të tregut mediatic.

Për ta bërë sa më të prekshme këtë analizë, po e filloj me komodifikimin, një virtut bazë i kapitalizmit liberal.

Komodifikimi është bashkim i dy fjalëve: fjalës “commodity” që janë mallra ose shërbime me një vlerë ekonomike dhe fjalës “modifikim” që është ndryshim në funksion ose formë. Komodifikimi është mënyra se si në kapitalizmin liberal realizohet objektivi i akumulimit të kapitalit ose vlerës nëpërmjet shndërrimit në

formë edhe në funksion të çdo gjëje të cilës mund t’i gjendet një vlerë këmbimi.

Për shembull, puna është komodifikim i njohurive, aftësive, talentit apo edhe i krahut të punës për të kryer procese të caktuara, duke i shndërruar këto të fundit në vlera monetare. Profesori shpërndan njohuritë e tij dhe paguhet për këtë. Shkrimtari shkruan një libër dhe siguron përfitime monetare duke komodifikuar të drejtat mbi veprën. Shpikësi komodifikon të drejtat mbi përdorimin e shpikjes së tij,

Punonjëset e seksit kanë komodifikuar marrëdhëniet seksuale të cilat në funksionin e tyre të parë – e kryesisht moral – nuk janë për shitje. Ndërsa, në një spektakël të tillë konkurrentët përpiqen të komodifikojnë trupin, ndjenjat, emocionet, veset e pse jo edhe e jetën tyre private.

Vëllain e Madh dhe formatet e ng-

jashme me të, ekonomistët i lidhin me tregun e vëmendjes. Edhe pse shpesh diskutohen si një zhanër unik psikosocial, këto formate ofrojnë një mënyrë punësimi për njerëzit që duan të pasurohen nëpërmjet vëmendjes. Pra, një aktor/e, një gazetar/e, një moderator/e dikur të punësuar në një shfaqje a emision me skenar, shndërron në interpretues në një sipërmarrje me buxhet të ulët, me qëllim sigurimin e vëmendjes më të gjerë të publikut.

Të gjithë këta “të punësuar” kanë shpresën se me anë të mediave sociale, famën e fituar në “shtëpinë më të famshme në botë” do ta monetarizojnë në të ardhmen e afërt. Ata ëndërojnë të shndërron në “tabela frymore marketingu në Instagram” ose të vazhdojnë të jenë protagonistë në formate të tjera po kaq surrugato nga përmbajtja.

Ndaj, jo pa qëllim, këto formate janë konkurrese, pasi konkurrimi është formula ekselente për të rritur audiencën dhe bashkë me të fitimet, sepse dramati, viktimizimi dhe narrativat emocionale që janë kaq të nevojshme për të siguruar vëmendje, prodhohen lehtësisht në formate konkurrese.

Ndërsa, vetëm audiencat e zgjuara mund ta kuptojnë se “realiteti” aty nuk mbart ndonjë ngjashmëri me realitetin. Roza Lati për shembull e di mirë që është e punësuar në një sipërmarrje nga e cila ose mund të fitojë ose mund të dal me gisht në gojë. Ndaj, që të fitojë, duhet të debatojë ashpër me kë i del përpara, të shëtisë me tanga nëpër shtëpi, të tregojë pse u nda nga i dashuri, madje edhe të

kërcënojë se është e zonja të katrorizojë organet njerëzore (natyrisht të rrumbullakëta). Ndërsa, ndonjë tjetër që të ofrojë spektakël, loton në një dramë të vërtetë malli në mënyrë që historia të bëhet më e trishtuar dhe më dramatike për të tërhequr vëmendjen e publikut.

Fituesi i vitit të kaluar, edhe pse shpiku një sëmundje të rëndë e shkoj edhe në urgjencë, prapë fitoi. Për të gjithë këtë ofertë racionalisht irrituese, ka një kërkesë emocionalisht të pranueshme. Natyra njerëzore magjepset nga tragjedia, konfliktet ekstreme dhe shkeljet e normalitetit. Ato janë hipnotike për t’u parë, aq më tepër kur ndodhin në televizion.

E pra, ndërsa është lejuar të lulëzojë një treg që mund të plotësojë nevojat më të dobëta e më të errëta të natyrës njerëzore, që shpërblen vulgaritetin, mashtrimin dhe injorancën, por që i siguron produksionit dhe fituesit shumë para e famë (madje këtij të fundit edhe një intervistë në podkastin e Kryeministrit!), ç’faj kanë Roza, Juli që ndërroi mendje apo Romeo, që duan me çdo kusht të fitojnë?

Tregu i lirë dhe i parregulluar nuk kujdeset për normat morale e shoqërore, ndaj edhe në procesin e ndërtimit të kapitalizmit liberal, duke rendur pas suksesit i cili matet vetëm nëpërmjet parasë edhe duke neglizhuar vlerat e përbashkëta shoqërore, privatizuar çdo gjë publike dhe po shesim në publik çdo gjë private. Ndaj mos e gjykoni Rozën. Ky treg mediatic këtë produkt ka.

LORD BAJRONI NË LETRËN DËRGUAR NËNËS: I DUA SHQIPTARËT SHUMË, JANË TË ASHPËR, POR JANË RACA MË E BUKUR NË BOTË

Poeti romantik anglez, Bajroni lindi në Londër më 22 janar 1788 në një familje aristokrate të varfëruar. Kur ishte dhjetë vjeç, me vdekjen e xhaxhait, Bajroni trashëgoi titullin Lord dhe pallatin e çifligun Newstead Abbey. Më 1801 Bajronin e dërguan në Harrow, në shkollë, ku studioi gjuhët greke e latine, historinë dhe letërsinë angleze. Në moshën 18 vjeçare, Bajroni hyri në Universitetin Kembrixhit (Trinity College). Më 1809 zuri vendin e tij në Dhomen e Lordëve, ku u shqua për idetë përparimtare. Po këtë vit ndërroi një udhëtim nëpër Evropë.

Gjatë vizitës së tij në Shqipërinë Jugore, më saktësisht në Janinë, Lord Bajroni mori si kujtim nga ato vise një kostum tradicional shqiptar. Do të ishte pikërisht bukuria dhe e veçanta e këtij kostumi, që në verën e vitit 1813 do ta shtynin piktorin Thomas Philips që të realizonte portretin e famshëm të Lord Bajronit veshur me kostumin shqiptar, me titull “Portrait of a Nobleman in the dress of an Al-

banian” (Portret i një fisniku me veshje shqiptare). Portreti u vendos në Royal Academy dhe tani është i vendosur në ambasadën britanike në Athinë.

Midis veprave letrare të tij, një vend të rëndësishëm zë poema “Çajld Harold’s” (Childe Harold’s Pilgrimage, 1812-1817), shkruar në bazë të përshtypjeve nga udhëtimet të poetit në Spanjë, Greqi, Shqipëri, Zvicër, Itali etj. Poemën e përshkron patosi i luftës për liri të popujve të shtypur e të robëruar. Në të, Xhorxh Bajroni u këndoi traditave dhe zakoneve burrërore të shqiptarëve, trimërisë dhe dashurisë së flaktë të tyre për lirinë.

Në letrën dërguar nënës së tij në datën 12 nëntor 1809, midis të tjerash Bajroni shkruan: “...I dua shqiptarët

shumë. Të gjithë shqiptarët janë të lindur të ndershëm dhe besnik, janë të ashpër... por janë ndoshta raca më e bukur në botë për nga paraqitja. Në udhëtimin që bëra, kam rojtur një herë dy ditë, dhe një herë tjetër tri ditë, në një kazermë shqiptarësh, dhe s’kam gjetur kurrë ushtarë aq të pëlqyer sa shqiptarët, ndonëse kam qenë në garnizonet e Gibraltarit e të Maltës, dhe kam parë shumica ushtarësh spanjollë, frengj, sicilianë dhe anglezë. Nuk më rodhën gjësende, dhe më ftuan me gëzim të marr nga zahireja dhe nga qumështi i tyre...”

Në vitin 1823 Bajroni u nis për në Greqi ku u bë frymëzues i luftës për pavarësi kombëtare të Greqisë kundër turqve. Nuk arriti të shihte çlirimin e saj sepse u sëmur nga ethet dhe vdiq



në Mesolongj, më 19 prill 1824, në moshën 36-vjeçare.

VETON SURROI

VITI I ÇKA NËSE?

Ballkani Perëndimor u frikësua me vitin 2024 si vit kur mund të fitojë Trumpi, e djathta ekstreme në Evropë dhe Putini në Ukrainë. Tashmë kemi hyrë në të, por Ballkani Perëndimor nuk ka bërë kthesë vendimtare për integrim në BE.

Përkundrazi, siç dëshmoi Banjska në shtator të vitit të kaluar, ka më shumë liri të lëvizjes së urrejtes e të destabilizimit mes vendeve të Ballkanit Perëndimor sesa të katër lirive evropiane që lidhen me tregun e përbashkët

1.

Ka ardhur viti i “Çka nëse?”

Në katër vjetët e fundit shumë transatlanticistë, liberalë e miq të Ballkanit Perëndimor kanë përsëritur se koha për të arritur marrëveshje që e vendosin Ballkanin Perëndimor në një qartësi integrimi në BE, duke lënë anash konfliktet e viteve '90, është mu tani. Me “tani” përshkruhej koha e presidentit Biden në Amerikë dhe Komisionit Evropian, Van Der Leyen, që për dallim të atij të mëhershëm kishte shpallur se dyert e BE-së për Ballkanin Perëndimor ishin të hapura.

Arsyetimi ishte i thjeshtë dhe pak e shumë bardhezi. Bardh: tani janë rreshtuar letrat (apo yjet në qiell) si është më së miri në Amerikën e pas-Trumpit e BE-në e pas-Junckerit (që kishte deklaruar në fillim të mandatit se nuk shihte shtet të ri të Ballkanit në BE). Zi: nëse nuk shfrytëzohet rasti tani, do të vijnë letrat (apo yjet e tjera), si p.sh Trumpi në Amerikë e forcat e ngjashme me të në Evropë, dhe më nuk do të jetë e mundur kthesa historike e Ballkanit Perëndimor kah e mira.

Në ligjërimin e deritanishëm nga miqtë liberalë e transatlanticistë vlente kërcënimi i butë: gjërat duhet të rregullohen në Ballkanin Perëndimor në këtë interval historik, sepse “çka nëse...?”, e pas kësaj pyetjeje vinte një përshkrim skenarësh, që fillonte me rizgjedhjen e mundshme të Trumpit si president amerikan e deri te zhvillimet negative në Evropë, prej zgjedhjeve që favorizojnë të djathtën e skajshme deri te humbja e Ukrainës në luftë.



2.

Hyrja në vitin 2024 nënkupton se “çka nëse” nuk është ndoshta realitet i kërcënimeve të realizuara, por është gjithsesi realitet i viteve të shpenzuara të frikësimit. Pra, jo, nuk është arritur asnjë gjë e rëndësishme që do të tregonte për një rrugë të sigurt të Ballkanit Perëndimor drejt BE. Vendet e BE dhe të Ballkanit Perëndimor nënshkruan zotimin për treg të përbashkët të Ballkanit Perëndimor më 2020 në Sofje dhe jo që nuk janë më afër këtij tregu, por animozitetet dhe krizat identitare janë më afër se ç’është tregu i përbashkët. Siç dëshmoi Banjska në shtator të vitit të kaluar, ka më shumë liri të lëvizjes së urrejtes e të destabilizimit mes vendeve të Ballkanit Perëndimor sesa të katër lirive evropiane që lidhen me tregun e përbashkët.

Rtjedhimisht lidhet njëri argument: miqtë transatlanticistë nuk kanë nevojë më për frikësim me skenarë negativë të së ardhmes, sepse e tanishmja është mjaftueshëm e keqe. Pra, nuk ka

nevojë të thuhet se Ballkanin Perëndimor e presin katër vjetët e Trumpit, Orbanit, Parlamentit Evropian, ku fjalën kryesore mund ta ketë e Djathta e skajshme alla Wildersi holandez. Katër vjetët që po kalojnë me politika të Bidenit, Von Der Layen e Macron-Scholz nuk është se krijuan një kthesë të dukshme pozitive në Ballkanin Perëndimor.

3.

Natyrisht, e udhës do të ishte që vendet e Ballkanit Perëndimor të zgjoheshin më 2024 dhe të konstatonin se tashmë viti i “çka nëse” ka filluar e se nuk duhet ta presin fundin e tij, sepse mund të jetë më i keq se fillimi, dhe se duhet të arrijnë disi ta bëjnë kthesën vetë. Por, kjo nuk do të ndodhë. Fillimisht, sepse këto vende janë të lidhura me fuqitë transatlantike dhe përpjekjen e tyre për të zgjidhur diçka gjatë kësaj periudhe sa nuk kemi hyrë në “çka nëse”. Dhe dy, sepse brenda Ballkanit Perëndimor tashmë ekzistojnë përlllogaritje të ndryshme për skenarët e fundit të këtij viti. Nuk është perspektiva e

njëjtë e Prishtinës, Sarajevës, Beogradit apo Podgoricës për zhvillimet në SHBA, Ukrainë a Parlament Evropian. Lufta në Ukrainë mund të arrijë në pozitë që të mos ketë fitues të qartë ushtarak, zgjedhjet në SHBA mund të prodhojnë një president që nuk i jep pesë para për Evropën e Parlamenti Evropian i Robert Schumanit mund të prodhojë një shumicë që i afrohet më shumë Robert Ficos të Sllovakisë. (Ai në “Pravda” të Bratislavës kritikon Perëndimin për ndihmë Ukrainës dhe bën analogjinë me Rusinë e vitit 1941 që e fitoi luftën më 1944).

Ballkani Perëndimor ka hyrë në vitin e “çka nëse” si vështrues, si konsumator i lajmeve që do të jenë ekzistenciale për të. Çdo gjë është me rëndësi: zgjedhjet në Tajvan, sepse tërheqin vëmendjen amerikane kah Kina, lufta në Gaza, sepse tërheq investime diplomatike e ushtarake kah Izraeli e në dëm të Ukrainës, lufta në Ukrainë, sepse dështoi kundërofensiva verore dhe viti 2024 mund të jetë vit defensiv për ukrainasit dhe rrjedhimisht vit i

hapjes së negociatave për një armëpushim me Rusinë, zgjedhjet presidenciale amerikane, sepse mund të sjellin sërish një administratë të paparashikueshme në shtetin më të fuqishëm në botë...

4.

Do të jetë e vështirë kërkesa për një politikë koherente të vendeve të Ballkanit Perëndimor apo e Perëndimit ndaj tij, në masë të madhe sepse nuk ekziston as koherencë në Ballkan Perëndimor e as koherencë në Perëndim.

Në që të dy rastet, prej kohësh, e vetmja gjë koherente është ideja se duhen mbyllur sytë ndaj faktit se Ballkani Perëndimor është ende zonë e konflikteve të papërfunduara dhe se mjafton që të bashkohen tregjet e këtyre vendeve, të këmbehen mallrat e lëvizin automjetet dhe disi gjendja do të rregullohet vetvetiu.

Dhe, kjo koherencë do t'i mbajë vendet e Ballkanit Perëndimor në pozitën e vëzhguesit, duke parë se si po zhvillohet viti 2024, ai me të cilin është kërcënuar “çka nëse”.

AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE?

Akoma nuk jeni regjistruar në Google



- Business Cards
- Logos
- Posters
- Banners
- Flyers
- Video Marketing
- Online Marketing

LONDON

Për çdo konsultim mund te vini në
zyrat tona

020 7018 7929
073 4066 5946
078 5997 7545

Adresa e zyrave:
30 Avenons Road,
London E13 8HT

ALFRED LELA

Në pranverën e 2013, Edi Rama dhe Partia Socialiste, filluan të qarkullojnë sloganin “fajin e ka Saliu”. Këshilltarët e huaj të pr-it, me sa duket, kishin ideuar një fushatë dy drejtimëshme ku PS riemërohej si “Rilindja”-e cila do të instalohet pas rrëzimit të kryeministrit Berisha, 8 vite në krye të vendit.

Sigurisht, sloganet e fushatave janë ‘të pafajshme’, edhe kur ato qëllojnë të jenë më agresive apo më manipulativet se ç’duhet. Slogani u bë tepër i shpejtë, vit pas viti, edhe pse Sali Berisha kishte dhënë dorëheqjen nga drejtimi i PD, duke mbetur deputet dhe autori zulmëmadh i një faqeje në Facebook ku “qytetari dixhital” bënte kërdrinë me denoncime, socialistët shfaqeshin sërish në debate mediatiqe dhe, pa kurrfarë zori deklarorin ‘fajin e ka Saliu’. Slogani kështu po dilte nga fushata elektorale dhe roli i vet dhe po shndërrohej në diçka tjetër. As më pak e as më shumë po një fushatë persekucioni politik me qëllim, së pari vrasjen karakteriale të Sali Berishës dhe, në finale, largimin e tij nga skena me të gjitha mjetet.

Është rasti kur një slogan është më shumë se parulla e një fushate, një strategji e qartë politike për të ndërriuar me mjete deus ex machina opozitën e një vendi.

Akuzat mediatiqe u bënë sfondi i një përpjekjeje më programatiqe dhe diabolike për ta targetuar z. Berisha, jo vetëm si sinonim i të këqijave të së shkuarës, por si një pengesë në rrugën e së ardhmes së vendit. Ngjarjet duhen parë nga perspektiva në retrospektivë për të shpërndarë pak mjegullën e habisë për të huajt e instaluar në Tiranë, që heshtnin para skandaleve të “qeverisë Rama”. Kanabizimi përshëndetëj si luftë kundër drogës, korrupsioni si betejë për zhbërjen e tij, shkëlja e të drejtave të njeriut si reformacion, e me radhë.

'FAJIN E KA SALIU', NGA SLOGAN ELEKTORAL NË STRATEGJI PERSEKUTIMI



Prania gjithnjë e më e madhe e Fondacionit Shoqëria e Hapur dhe George e Alex Soros-it, plani i tyre për reformën në drejtësi dhe shkëmbimet e territoreve në Kosovë, ideja e materializuar e Ballkanit të Hapur etj., e panë Sali Berishën thujtë të vetëm përballë një komploti transnacional.

Edi Rama e paralajmëroi në Kuvendin e Shqipërisë, muaj përpara, shpalljen non grata të Sali Berishës. Të njëjtën gjë edhe në rastin e Britanisë së Madhe. Që qeveritë e vendeve partnere i shërbenin kryeministrit të Shqipërisë informacione për kundërshtarit politik, të cilat ai mund t'i përdorte për të ngjyrosur sloganin e dalëboje “fajin e ka Saliu”, kjo më së paku ka shije të keqe gjeopolitike.

Një fakt i mëvonshëm nuk pyeste as për shijen dhe as për kodet, por shpaloste më gjerë dhe më thellë homo corruptus-in që ndërkombëtarët mbështesnin te Edi Rama dhe shpura e tij. Dosja McGonigal ekspozonte

thelbin banal të sulmit të orkestruar ndaj Partisë Demokratike dhe Sali Berishës. Lulzim Basha gjendej aty vetëm si aksesor i planit. Nëse kemi një material shtrëngues për të, atëherë do t'i duhet të zgjedhë mes atit politik, demokratëve dhe kokës së vet.

Luli u dorëzua, por jo Saliu. Ky mosdorëzim hedh në erë edhe sloganin më jetëgjatë (ndoshta) në historinë politike të botës ‘fajin e ka Saliu’ sepse, si rregull ai që ka faj, dorëzohet dhe tërhiqet, nuk duhet në prani të fajit.

Non gratat amerikane dhe britanike ndihmuan Bashën dhe Ramën për të kënduar refrenin e lodhshëm dhe hipokrit se janë ata kryqtarët e euroatlantikes në këtë vend, por nuk pakësuan as nervin politik të Berishës dhe as mbështetësit e tij.

Në dy palk zgjedhje Sali Berisha u dëshmuua si shefi i forcës së dytë më të rëndësishme në vend, duke e mbulluar me turp pasardhësin dhe paraad-

hësin e tij në krye të PD.

Në këto kushte ‘fajin e ka Saliu’ duhej ripërpunuar, apo më saktë duhej çuar faji te Saliu, pasi Saliu nuk pranononte të shkonte te faji. Për këtë fazë të aksionit u vu në lëvizje SPAK, një prej institucioneve të drjetësisë së re, platformën e të cilës (mos harroni!) e kishte hartuar dhe paraqitur në Tiranë “Fondacioni Soros”.

Sali Berishës i shkon shprehja e Xhulio Andreotit ‘më akuzojnë për çdo gjë në Itali, përjashtoj Luftrat Punike’, por ndër akuzat, tre më qendroret kanë qenë 97-a, Gërdeci dhe 21 janari. Për të përpunuar ‘fajin’ megjithatë, u zgjodh një çështje tjetër, më pak e trajtuar, privatizimi i “kompleksit Partizani”. Pse? Në terma të propagandës, “Partizani” ngjiste më lehtë. Bashkoheshin në të besnikëritë sportive, toka dhe prona- dy njësi që gjithmonë përbëjnë lakmi në mitologjinë popullore dhe ‘kullat’. Vini re që ndërtesat e kompleksit cilësoshin nga mediat pranë qeverisë “kulla”, edhe pse nuk ishin më shumë se pallatet e zakonshme 9 apo 10 katëshe të çdo lagjeje në Tiranë. Me këtë rast qeveria që akuzohej për betonizimin e Tiranës me kulla kërkonte të krijonte përshtypjen se kullat në fakt i bënë Saliu. Me gjasë, ‘tehu’ më djallëzor i përgjydhjes së Partizanit kishte të bënte me përfshirjen e dhëndrrit të Berishës, Jamarbër Malltezi. Kjo e bënte ‘afërën’ sagë familjare dhe çonte ujë te akuzat e vjetra e të pashtershme të përfshirjes së familjarëve të Berishës në akte korruptive. Pra, hetimi i SPAK takohej me akuzat e Ramës ndër vite dhe me non gratan.

Qarku i persekucioni politik të Sali Berishës mbyllet kështu i plotë. 10 vjet pas ardhjes në pushtet të social-

istëve, edhe pse PD kishte qeverisur tashmë më pak se PS gjatë 30 viteve të paskomunizmit në Shqipëri, edhe pse skandalet e qeverisë Rama i përkasin kategorisë së epikes së korrupsionit, faji duhej deleguar te Saliu.

Në këtë kuptim, atë të përpjekjeve të politikës, që nëpërmjet drejtësisë të godasë kundërshtarit, Sali Berisha futet në radhën e politikanëve të djathtë si Berlusconi dhe Trump.

Në një kuptim tjetër Sali Berisha qëndron më vete si humanist. Në periudhën 1991-1992, kur partia që ai drejtonte synonte pushtetin, Sali Berisha shpiku dhe përdori sloganin ‘bashkëvuajtës dhe bashkëfajtorë’. Me të donte të thoshte se nuk ka vend për hakmarrje. Në Shqipërinë e Enver Hoxhës të gjithë kemi qenë pjesë e fajit dhe vuajtjes. Nuk e di se nga e nxori Berisha atë paradigmë, por rrënjët e saj janë, me siguri, të krishtera. Berisha, paraqitej si lideri thelbi i të cilit ishte mëshira kristiane, pra aspekti i huaj për Europën.

Në këtë finale, në perspektivën e re që na lejon të shohim në retrospective, Sali Berisha ka gëbuar. Ai duhet të kishte zgjedhur kodin hebraik ‘një sy për një sy’. Sepse sot, ata që ishin më fajtorë se Berisha, në sistemin ku, sipas Doktorit, të gjithë ishin ‘bashkëvuajtës dhe bashkëfajtorë’, kthehen me shpagim për ta shpallur atë si fajtorin e vetëm.

Në këtë kthesë të fatit qëndron sot Sali Berisha. Fajtorët e djeshëm të komunizmit, veshur me petkat e sotme të progresivizmit, vijnë për t'i thënë se për të nuk ka bashkëvuajtës.

Një mësim tjetër po nga Krishtërimi: “Asnjë vepër e mirë nuk kalon pa u ndëshkuar”.

POROSISNI BANNERIN PER BIZNESIN TUAJ

Jepini diapazon biznesin tuaj

Te gjitha llojet

- PVC Banners
- Premium Roller Banners
- Pull Up Roller Banners
- Mesh Banners



Adresa e zyrave:
30 Avenons Road, London, E13 8HT

Na kontaktoni:
020 7018 7929
073 4066 5946



GJERGJ META

Universi, në një natë me qiell të pastër dhe një det i qetë i paskaj, sa më magjepsin, aq edhe më frikësojnë.

Ndërsa pohoj këtë gjë, më vijnë ndërmend leksionet rreth fascinsum et tremendum lidhur me Qenien apo Zotin, në lëndën e Metafizikës. Për shembull, kundrimi i një qielli plot me yje apo pamjet nga teleskopët gjigandë të NASA-s, shkaktojnë brenda meje këtë përzjerje ndjesish magjepsje dhe frike.

Nuk e di për ç'arsye konkrete, por ndjenja ime religjioze ka nisur disi e lidhur me vdekjen dhe me pafundësinë e gjithësisë apo thënë më mirë, me mbijetesën e saj ndaj vdekjes sime. Ndieja gati-gati një lloj xhelozie që gjithësia do t'i mbijetonte vdekjes sime.

Hera e parë që jam përballur me infinitin, ka qenë në orën e Matematikës. Aty e kam mësuar edhe simbolin e tij. Në vitin 1994, kam qenë i shtruar në një prej spitaleve të Barit. Një mjek, i cili punonte atje, më pati thënë se çdo sëmundje, qoftë e



lehtë, qoftë e rëndë, ka një pafundësi mundësish, pasi ndërmjet 0-s dhe 1-shit gjenden një infinit numrash dhe po ashtu nga 0-ja fillon një infinit

numrash.

Nuk e di nëse ky infinit është real apo ka të bëjë me pamundësinë e njeriut

MAGJEPSJE DHE FRIKË

për të imagjinuar a vërtetuar më përtej, por mua më bëhet gjithnjë e më i vështirë imagjinimi i infinitit. Aq i vështirë sa është njëherazi magjepsës dhe i frikshëm.

Cila mbizotëron mbi tjetrën? Nëse mbizotëron magjepsja, lind guximi deri në marrë. Kështu pyesja veten dhe përballë një deti të qetë (edhe deti e jep këtë efekt pafundësie). Kur isha adoleshent, nganjëherë shkoja e zhytesha në det qysh në orën 6 të mëngjesit dhe notoja me epsh a thua se doja t'i dilja në fund e ta zotëroja infinitin që më shfaqej para syve. Lodhja e gjymtyrëve, të cilat përplasheshin me ujën duke e çarë drejt thellësisë, shenjonte edhe trajtat e para të frikës. Magjepsja më thoshte: "Vazhdo edhe pak!", kurse frika më pëshpëriste ngadalë: "Nдалu e kthehu!" Derisa një ditë u deshën krahët e fuqishëm të një shokut tim më të madh, që të më shpëtonin nga mbytja. Aty njoha limitin dhe në ditët në vazhdim nuk shkoja më tej tij.

E megjithatë, limiti nuk e kishte fshirë as magjepsjen, as frikën. Por ai u bë një udhërrëfyes i mirë në shtigjet e infinitit, një lloj Virgjili në botën e Hadës, madje edhe në ëndrra, të cilat për vetë natyrën e tyre nuk kanë një nisje e as një mbarim ose të paktën në nuk i kujtojmë ata.

Kur në kapërcyell të shekullit XIX, Freud-i zbuloi pandërgjegjen, element i së cilës janë edhe ëndrrat, njeriu preku një univers tjetër, magjepsës dhe të frikshëm njëherësh, të cilin, vetë zbuluesi i tij, e krahasonte me një ajsberg të ndarë në tri pjesë: Ego, Superego dhe Idi. Në ato vite, anija "Titanic", simboli i një krenarie gati të pathyeshme detare, u fundos në oqean nga përplasia me një ajsberg.

Ai ajsberg u bë limiti i krenarisë njerëzore, racionale, shkencore dhe shpikëse. Këto të fundit u mbytën nga një ajsberg, sikurse strategu i madh, Pirro, nga një vazo me lule.

VOA

"KOSOVA PO ARMATOSJET NË MËNYRË TË PALIGJSHME"

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, akuzoi fuqitë perëndimore për armatosjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe opozitën e mediat pro opozitës në Serbi se janë në shërbim të këtyre fuqive. Gjatë një veprimtarie në Beograd, ai tha se është duke menduar se "si të fillojnë hetime për armatosjen e të ashtuquajturës Forca e Sigurisë së Kosovës dhe atyre që po ndihmojnë në këtë armatosje, në kundërshtim me Rezolutën 1244.

Dua të hetoj se kush e shkeli Kartën e Kombeve të Bashkuara, dhe si guxuan ta bëjnë atë ... Po mendoj si të mos e sjell vendin në pozitë të vështirë dhe njëkohësisht të ruhet e drejta ndërkombëtare", tha ai. Më herët gjatë këtij muaji Departamenti amerikan i Shtetit miratoi shitjen e mundshme të raketave Javelin për Kosovën, me një vlerë prej 75 milionë dollarësh.

"Kjo shitje e propozuar do të mbështeste synimet e politikës së jashtme dhe sigurisë kombëtare të Shteteve të Bashkuara duke përmirësuar sigurinë e një partneri evropian, i cili është një forcë e rëndësishme për qëndrueshmërinë politike dhe ekonomike në Evropë", tha Departamenti i Shtetit, sipas të cilit shitja nuk do të ndryshojë ekuilibrin ushtarak në rajon.

Presidenti serb i cili e kishte cilësuar njoftimin "një zhgënjim të madh për Serbinë", sulmoi mediat pro opozitare dhe opozitën në Serbi se "nuk duan t'ia dinë çfarë po i bëjnë të huajt dhe shqiptarët Serbisë".



"Juve ju intereson se si ta ndëshkoni Serbinë, sepse disa serbë deshën t'i mbronin vatrat e tyre", tha presidenti serb i pyetur nga gazetarët për ngjarjet në fshatin Banjskë në veri të Kosovës me 24 shtator të vitit të kaluar, kur një grup serbësh të armatosur sulmoi policinë e Kosovës duke vrarë një oficer dhe plagosur dy të tjerë. Kosova e ka akuzuar Beogradin për organizimin dhe armatosjen e grupit, por Beogradi mohon të jetë përfshirë në të. Përgjegjësinë për sulmin e mori përsipër Milan Radoičić, ish nënkryetar

i Listës Serbe, partisë kryesore të serbëve të Kosovës, e cila është themeluar dhe mbështetur nga Beogradi. Incidenti që vlerësuar nga më të rëndët që kur Kosova shpalli pavarësinë e saj në vitin 2008 duke nxitur shqetësimin e diplomacisë perëndimore për qëndrueshmërinë në rajon dhe thirrjet për vënien e autorëve para drejtësisë.

Autoritetet në Serbi e ndaluan Milan Radoičićin disa ditë pas sulmit nën akuzën "bashkim me qëllim të kryerjes së veprave kriminale, prodhimit,

posedimit, mbajtjes dhe trafikimit të armëve të zjarrit dhe lëndëve shpërthyes, dhe krime të rënda kundër sigurisë së përgjithshme". Por, ai u la më pas i lirë me kusht që të mos largohej nga Serbia, dhe iu ndalua të shkonte në Kosovë. Pas sulmit të 24 shtatorit policia e Kosovës gjeti një sasi të madhe armësh në fshatin Banjskë.

Presidenti serb tha se pjesëtarët e grupit kanë kryer vepra penale dhe do të përgjigjen, por "kur shoh për çfarë armësh flitet... ata thonë se kishte pis-

toleta, pushkë, raketa-hedhës dore. Epo, prisni... keni sjellë 'Javelin' të gjitha ilegalisht... Dhe nuk përgjigjen. Mund ta bëni. Jeni të mëdhenj e të fuqishëm dhe keni shërbëtorët tuaj këtu (në Serbi) nga ata politik deri te ata medial...", tha presidenti serb.

Në dhjetor të vitit 2018, Parlamenti i Kosovës miratoi ligjin për shndërrimin e Forcës së Sigurisë në ushtri të Kosovës, një proces që do të zgjasë 10 vjet dhe nuk do të zëvendësojë forcat e NATO-s që vazhdojnë të kenë rreth 5 mijë trupa paqeruajtëse në Kosovë, disa qindra prej të cilëve janë amerikanë.

Numri i trupave të NATO-s u shtua pas 24 shtatorit mes shqetësimeve të perëndimit se Rusia mund të provojë destabilizimin e Ballkanit për të shpërqendruar vëmendjen nga agresioni i saj në Ukrainë. Pas sulmit diplomatik perëndimorë u vunë në përpjekje të reja për të përshpejtuar procesin e normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve.

Nga Qeveria e Kosovës kërkohet të themelojë Asociacionin e komunave me shumicë serbe, ndërsa Qeverisë së Serbisë të përmbushë detyrimet që çojnë drejt njohjes de fakto të Kosovës. Beogradi ka theksuar se nuk do të zbatojë asgjë që çon në njohjen e Kosovës./VOA

TË BLESH DY HERË JETËN DHE SHËNDETIN!

MONITOR

Në vitin 2020, Shqipëria doli e para në Europë për treguesin e vdekjeve shtesë, të cilat ishin mbi 20% më të larta se mesatarja e viteve 2015-2019 (e ndjekur nga Maqedonia e Veriut (rreth 18%) dhe Kosova (me rreth 17%), sipas raportimeve të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Komisionit Europian.

E njëjta tendencë vijoi dhe në 2021, kur të tre këto shtete panë rritjen më të lartë të fataliteteve shtesë në periudhën e pandemisë.

Shtetet e varfra, përveçse nuk kishin kapacitetet e duhura spitalore për të përballuar pandeminë, nuk kishin as luksin për të kufizuar lëvizjet dhe as kushtet për të respektuar masat e distancimit social, prandaj zgjodhën ekonominë përballë jetës së qytetarëve të tyre. Këta të fundit reagon duke "blerë" jetën.

Të dhënat e përditësuara së fundmi nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) tregojnë se shpenzimet nga xhepi të shqiptarëve për shëndetësinë janë rreth 60% e totalit, me rritje të ndjeshme me 10 pikë përqindje nga 2015-a dhe më të lartat në Europë (e dyta pas Shqipërisë është Maqedonia e Veriut, me gati 42%).

Kjo shifër është dëshmi e një sistemi shëndetësor publik, që nuk arrin t'u shërbejë qytetarëve të vet, e një skeme sigurimesh shëndetësore të detyrueshme, që nuk e realizon qëllimin e vet, lehtësimin e kostove shëndetësore për shtetasit, megjithëse pretendohet që kemi një shëndetësi falas.



Ajo është reflektim i niveleve të ulëta të investimeve për shëndetësinë në vite dhe aplikimin de facto në Shqipëri të një shërbimi mjekësor më së shumti privat, madje me skema sigurimesh) jofunksionale.

Të dhënat krahasuese të Organizatës Botërore të Shëndetësisë për 42 vende europiane tregojnë se Shqipëria renditet e treta në Europë për shpenzimet më të ulëta buxhetore për shëndetësinë. Mesatarisht, shtetet europiane japin për financimin e shëndetësisë, 5.2% të PBB-së, ndërsa Shqipëria e ka këtë tregues afërsisht 3%.

Madje në 2022, kur janë dhe të dhënat më të fundit të disponueshme nga INSTAT, shpenzimet buxhetore për

shëndetësinë, në raport me PBB-në ishin në nivelin më të ulët që nga viti 2017, duke zbritur për herë të parë nga ai vit pak nën nivelin prej 3%.

Krahas nivelit të ulët në krahasim me vendet e tjera, një tjetër problematikë është dhe rishpërndarja e tyre. Vitet e fundit, fokusi është vënë në projektet koncesionare në shëndetësi, disa prej të cilave kanë rezultuar jofunksionale dhe janë tashmë nën hetim nga njësi e posaçme antikorupsion, SPAK.

Për periudhën 2017-2013, buxheti i shtetit ka shpenzuar për katër koncesionet e shëndetësisë, sterilizimi, dializa, check up, laboratorë, rreth 26 miliardë lekë, ose 240 milionë euro, sipas të dhënave të pagesave faktike nga Ministria e Financave.

Këto para do të ishin të mjaftueshme për të ngritur, nga e para, të paktën katër spitale moderne.

Për më tepër, që përveç koncesionit të dializës, tre të tjerët janë tashmë nën hetim nga SPAK. Pra, ky i fundit dyshon për abuzime për 80% të shumës që është dhënë në total, për këto koncesione në 2017-2023.

Edhe në vitin 2024, buxheti ka parashikuar pagesa prej 5.4 miliardë lekësh për këto katër koncesione, që është sa 10% e buxhetit të shëndetësisë (përfshirë pagesat për perkuadjesin social).

Në kahun e kundërt, financimet për shërbimet themelore shëndetësore, të

tilla si rimbursimi i barnave dhe kujdesi parësor, kanë mbetur në vendnumëro, në një kohë që nevojat për produkte farmaceutike dhe shërbime shëndetësore në një popullsi në plakje po rriten.

Treguesit zyrtarë referojnë se brenda buxhetit të shëndetësisë ka shpërndarje të deformuar të fondeve, me orientimin e tyre drejt koncesioneve joproduktive.

Të dhëna më të detajuara nga IQIVIA (lider global kërkimor për novacionin në shëndet) tregojnë se shqiptarët kanë akses të ulët te barnat kryesore që trajtojnë sëmundjet kardiovaskulare, onkologjinë, autoimmune, nervore, etj., në raport me Europën dhe rajonin.

Rënia e financimeve për produktet farmaceutike dhe shërbimet shëndetësore, shpërdorimi i asaj pjese financimesh publike të kanalizuar në formën e koncesionit, skemat jofunksionale të sigurimeve shëndetësore, të kombinuara me plakjen graduale të popullsisë dhe shtimin e barrës së sëmundjeve pas Covid, rezikojnë të përkeqësojnë më tej shëndetin dhe cilësinë e jetesës së popullatës me pasojë zinxhir në produktivitetin e ekonomisë dhe rëndimin e mëtejshëm të xhepave të popullatës.

Politikat shtetërore, që kanë si rezultat përkeqësimin e shërbimeve kryesore publike, si arsimit dhe shëndetësisë, përtej paaftësisë apo abuzimeve, po shërbejnë si faktorë nxitës të emigrimit. Në këtë mënyrë, kapitali njerëzor i shtetit shqiptar është nën sulm nga çdo anë.

(Monitor.al)

POROSISNI kartat e biznesit tuaj

Për çdo konsultim mund te vini në çdo kohë në zyrat tona
Na kontaktoni:

020 7018 7929 073 4066 5946 078 5997 7545

Adresa e zyrave: 30 Avenons Road, London, E13 8HT





AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE?



Business Cards 

Banners 

Posters 

Flyers 

Video Marketing 

Adresa e zyrove 

30 Avenons Road London E13 8HT



020 7018 7929

Mobile 073 4066 5946